



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Informatikë Biznesi”**  
**i**  
**Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar  
“I Biznesit”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

2. Dr. Alba Kruja

Tetor/2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Informatikë Biznesi”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 392, datë 10.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2020-2021):	13 PAE / 11 PAK (74%/26%)
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	(15+16+9)= 40
19	Komente / të tjera:	-

# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës;

Kolegji Universitar "I Biznesit" (KUB) është një institucion jo publik i arsimit të lartë i krijuar në zbatim të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe funksionon bazuar në VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 "Për licencimin e "Kolegji Universitar i Biznesit si Institucion i Arsimit të Lartë". Me Urdhër Nr. 3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ky institucion është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit në përputhje me licencën e dhënë, duke filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012. Akreditimi institucional i Kolegjit Universitar "I Biznesit" është bërë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 557 datë 16.11.2012, "Për akreditimin institucional të Kolegjit Universitar të Biznesit". Në vitin 2017 institucioni kreu akreditimin periodik nga ASCAL dhe Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (QAA), dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 100, datë 10.11.2017 me kohëzgjatje për 4 vite me afat deri në 09.11.2021.

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Biznesi" është licensuar me Urdhërin Nr. 392, datë 10.07.2018 të Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë. Sipas pikës 2 të këtij urdhëri, veprimtaria akademike ka filluar në vitin akademik 2018-2019. Ky program ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës së Fakultetit të Ekonomisë në KUB. Programi zhvillohet në 3 vite akademike, çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë dhe 60 kredite. Në përfundimin me sukses të ciklit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma Bachelor në "Informatikë Biznesi".

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017", Kolegji Universitar "I Biznesit" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të programit Bachelor në "Informatikë Biznesi", nëpërmjet shërbimit në AMS.

Ky raport bën vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të parë të programit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson angazhimin e Departamenti të Ekonomiksit dhe Informatikës si dhe Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi në KUB në përmbushjen e të gjitha detyrimeve dhe kritereve në zbatim të bazës ligjore dhe rregulloreve të studimit në fuqi, për ofrimin e programit Bachelor në "Informatikë Biznesi". Shkalla e përmbushjes së kritereve që përcakton standardi i akreditimit si dhe rekomandimet përkatëse në këtë proces të parë akreditimi të programit analizohen nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në vijim të këtij raporti.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Në kuadër të procesit të akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” të kërkuar nga Kolegji Universitar “I Biznesit”, ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji Universitar “I Biznesit”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli dhe Dr. Alba Kruja. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga Koordinatori teknik i ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Kolegji Universitar “I Biznesit”, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi”, përbërë nga 135 dokumenta në total. Ekspertët sipas një agjende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të këtij programi studimi, kanë realizuar vizitën në institucion në datat 8 - 9 Korrik 2021, në Kolegjin Universitar “I Biznesit”, sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Gjatë vizitës ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës. Drejtuesit e institucionit, personeli akademik dhe administrativ i Kolegjit Universitar “I Biznesit”, u angazhuan për t’iu përgjigjur kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ). Pas vizitës në institucion me kërkesë të GVJ, u vendosën në sistemin AMS edhe 10 dokumenta të tjera shtesë.

Pas rishikimit të dokumentacionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve gjatë vizitës në institucion, GVJ ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të këtij programi studimi, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Kolegji Universitar “I Biznesit”.

Vlerësimi i ekspertëve të jashtëm paraqitet në vijim të këtij raporti.

Më datë 23.09.2021, përmes sistemit AMS, Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB) është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot, 106/11, datë 23.09.2021. Më datë 01.10.2021, KUB përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot, 442, datë 30.09.2021.

### **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:**

#### **1. Paragrafi në draft RVJ**

##### **Standardi I.3 Kriteri 2**

KUB ka kryer një studim mbi tregun lokal të përpara hapjes së programit bachelor në IB. Në këtë material KUB ka raportuar fillimisht informacione lidhur me programin e studimit si: Misioni, Vizioni, Objektivat e Qëllimi i programit të studimit. Më pas studimi vijon me një analizë të shkurtër të tregut të punës dhe mundësive të tij, por kjo analizë nuk është mbështetur me evidenca nga të dhëna dytësore apo parësore, megjithëse në punim raportohet për një anketim të bërë në vitin 2016, por asnjë detaj lidhur me këtë pyetësor nuk është raportuar.

Për sa më sipër GVJ konkludon se metodologjia mbi të cilën është ndërtuar ky studim tregu, nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga tregu. Ekspertët gjithashtu rekomandojnë që studimi i tregut të shtrihet jo vetëm në mundësitë dhe nevojat e tregut të brendshë por edhe të atij jashtë Shqipërisë.

Megjithëse ky program ende nuk i ka ofruar tregut të diplomuarit e parë, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, KUB në mënyrë periodike realizon kontakte me studentët pas diplomimit me qëllim gjurmimin e punësimit të tyre. Ndërkohë Zyra e Marrëdhënive me Jashtë realizon kontakte dhe marrëveshje të vazhdueshme me punëdhënësit, lidhur me kërkesat dhe nevojat e tyre si dhe për të mbështetur procesin e realizimit sa më të mirë të programit mësimor, për të kryer sa më mirë praktikat profesionale si dhe për të mundësuar punësimin e studentëve. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se tre prej studentëve të vitit të tretë të programit bachelor në IB, kishin marrë oferta punësimi nga kompanitë ku ato kishin kryer praktikën profesionale. KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me kompani biznesi, OJF, si dhe institucione publike.

### ***Komenti i IAL***

*Kemi pataqitur studimin e tregut të vitit 2016 i cili është realizuar për hapjen e programit të studimit. Në Vitin Akadernik 2020-2021 Diplomohet brezi i parë i studentëve në Programin e Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi dhe për rrjedhojë KUB do të realizojë studime pas daljes së studentëve të parë dhe në mënyrë periodike bazuar në metodologjinë e rekomanduar nga ju.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se institucioni ka kryer një studim mbi tregun lokal të përpara hapjes së programit, por metodologjia mbi të cilën është ndërtuar ky studim tregu, nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga tregu. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## **2. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi II.1 Kriteri 2**

Programi i studimit Bachelor në IB, synon t'u ofrojë studentëve një formim të gjerë në llojshmëri të profesionit e specialiteteve në fushë e Informatikës së Biznesit si në sektorin publik ashtu edhe atë privat e jofitimprurës. Nëpërmjet lëndëve si Programim, Strukturë të Dhënash, Database dhe Menaxhim, Statistikë Biznesi, Modelim Biznesi, Financë, Makroekonomi, Kontabilitet, etj, ky program pajis studentët me njohuri të specializuara në gjuhët bazë të programimit, aftësi për përdorimin, përpunimin dhe analizën e informacioneve, aftësi për zbatimin e sistemeve të avancuara teknologjike, aftësi për analiza të ndryshme të biznesit.

Përtej këtyre lëndëve GVJ është i mendimit se institucioni duhet të ofrojë edhe lëndë operationale si Menaxhim Operacionesh apo Kërkim Operacionesh me qëllim aftësimin e studentëve drejt analizave sasiore të vendimmarrjes dhe përdorimit të burimeve të organizatës

si dhe krijimit të produkteve apo shërbimeve të cilat plotësojnë nevojat e konsumatorëve, duke siguruar efikasitetin dhe efektivitetin.

### ***Komenti i IAL***

*Në përmirësimet e vijueshme të kurrikulës dhe planit mësimor për Programin e studimit Bachelor në Informalitet Biznesi do merret në konsideratë përfshirja e modulit Menaxhim Operacionesh, megjithëse kjo lëndë aktualisht zhvillohet në programet mësimore të Ciklit të Dytë të Studimit Master.*

### **Argumentimi i GVJ**


GVJ në RVJ i sugjeron institucionit të ofrojë lëndë operationale në programin bachelor në IB si Menaxhim Operacionesh apo Kërkim Operacionesh me qëllim aftësimin e studentëve drejt analizave sasiore të vendimmarrjes dhe përdorimit të burimeve të organizatës si dhe krijimit të produkteve apo shërbimeve të cilat plotësojnë nevojat e konsumatorëve, duke siguruar efikasitetin dhe efektivitetin. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

### **3. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi II.1 Kriteri 3-6**

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së Planeve Mësimore, Syllabuseve të lëndëve, Literaturës së miratuar nga departamenti, si dhe takimeve të ndryshme gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, stafin drejtues dhe studentët, GVJ konstaton se programi Bachelor në IB:

- u ofron studentëve njohuri të përparuara në fushën e “Informatikës së Biznesit” nëpërmjet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të kësaj fushe si për kompanitë private, ashtu edhe për ato publike apo organizatat jo fitimprurëse;
- zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e ekonomisë, analizës së biznesit, si dhe informatikës e teknologjisë;
- përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018:
- programi është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 180 ECTS; studentit i ofrohen nga 11 lëndë gjatë vitit të parë, 10 lëndë gjatë të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 9 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit;
- kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet instrumentëve të ndryshëm të vlerësimit si: frekuentimi i lëndës, detyrat e kursit, testimet gjatë vitit, provimi përfundimtar;
- objektivat formues dhe kompetencat profesionale janë të përcaktuara;
- në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës;



- ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite; GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë të përcaktuara korrektësisht dhe se lëndët:

- bazë: kategoria A, përbëjnë 17.8 % të krediteve,
- karakterizuese: kategoria B, përbëjnë 54.4 % të krediteve,
- integruese: kategoria C, përbëjnë 11.7% të krediteve,
- plotësuese: kategoria D, përbëjnë 11.7% të krediteve,
- detyrimeve përmbyllëse: kategoria E, përmban 4.4% të krediteve;

- modeli i përdorur për hartimin e Syllabuseve është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Por ndërkohë ekspertët konstatojnë se në syllabuse nuk është i përcaktuar kodi i lëndës. GVJ rekomandon që institucioni të unifikojë paraqitjen e lëndëve me emërtimet dhe kodet përkatëse në syllabuse.

### ***Komenti i IAL***

*Kolegji Universitar i Biznesit është në proces kodifikimi të programeve dhe lëndëve/moduleve në komunikim me MASR.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se në syllabuset e programit nuk është përcaktuar kodi përkatës i lëndëve. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.


## **4. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi II.2 Kriteri 2**

KUB ka emëruar në rolin e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në IB, një përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale tij, por GVJ konstaton se stafi akademik i emëruar është i punësuar në institucion me kontratë dhe jo me kohë të plotë. Emërimi në këtë pozicion kyc të programit i një personeli akademik jo efektiv mund të jetë pengesë e përmbylljes me efektivitet të detyrave të këtij pozicioni. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, rezultoi që për problemet në mbarëvajtjen mësimore studentë kontaktonin me sekretarinë e fakultetit, ndërkohë që kjo mbarëvajtje duhet të mbikëqyret dhe koordinohet nga koordinatori i programit. Ekspertët janë të mendimit që institucioni në këtë pozicion duhet të emërojë një personel akademik efektiv.

### ***Komenti i IAL***

*Rolin dhe funksionin e drejtimit dhe koordinimit të departamentit e kryen dhe e realizon Përgjegjësi i Departamentit. KUB ka caktuar edhe një koordinator me qëllim që të garantojë cilësinë më të lartë dhe profesionale në përmbylljen e objektivave të programit të studimit.*



## Argumentimi i GVJ

GVJ konstaton në RVJ se stafi akademik i emëruar në rolin e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në IB, është i punësuar në institucion me kontratë dhe jo me kohë të plotë. Emërimi në këtë pozicion kyc të programit i një personeli akademik jo efektiv mund të jetë pengesë e përmbushjes me efektivitet të detyrave të këtij pozicioni. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

### **5. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi II.4 Kriteri 6**

Gjatë analizës së syllabuseve ekspertët konstatojnë se në pjesën më të madhe të lëndëve viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41 konsideron literaturën e 5 viteve të fundit. GVJ rekomandon që institucioni të rishikojë dhe rinovojë literaturën me atë të 5 viteve të fundit.

#### ***Komenti i IAL***

*Në literaturën e syllabuseve është ndjekur një politikë e mbajtjes së literaturës së të gjithë teksteve referuese të modulit krahas literaturës së përditësuar. KUB dhe Fakulteti i Ekonomisë do të realizojë përditësimin e literaturës së 5 viteve të fundit. Për këtë KUB ka të parashikuar çdo vit një buxhet të dedikuar për këtë qëllim.*

## Argumentimi i GVJ

GVJ konstaton në RVJ se në pjesën më të madhe të lëndëve të programit të studimit Bachelor në IB, viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41 konsideron literaturën e 5 viteve të fundit. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

### **6. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi II.5 Kriteri 1-3**

Për realizimin e programit bachelor në IB gjatë vitit akademik 2020-2021 janë të angazhuar 13 pedagogë si PAE dhe 11 pedagogë me kontratë (PAK).

Për sa i përket kualifikimeve të PAE:

- 6 pedagogë mbajnë gradën Dr;
- 1 pedagog është në proces doktore;
- 5 pedagogë kanë kualifikimin MSc.;
- 1 pedagog ka kualifikimin MP.

Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, programi:



- përmbush kërkesën ligjore për stafin akademik që të jetë të paktën 70% e stafit efektiv qëi mbulon programin akademik (VKM 418, Maj 2017).
- përmbush kërkesën ligjore e të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin akademik;
- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Megjithatë duke konsideruar që 6 nga pedagogët të cilët mbulojnë ngarkesën akademike në këtë program për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktorature, GVJ sugjeron që institucioni të shohi mundësitë apo të lidhi marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit për kualifikimin e mëtejshëm të stafit dhe të fillimit sa më të shpejtë të tyre të studimeve doktorale në fushat e tyre përkatëse.

### ***Komenti i IAL***

*KUB ka në proces doktorature 4 pedagogë. Kolegji Universitar i Bimesit ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL si Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës dhe do ti vendosë në efijçencë për kualifikim të stafit në grada shkencore dhe tituj akademikë.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se 6 nga pedagogët të cilët mbulojnë ngarkesën akademike në programin e studimit Bachelor në IB për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktorature. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## **7. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi III.3 Kriteri 5**

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi hapësirat e bibliotekës së institucionit janë komode, por biblioteka ka literaturë të kufizuar të botimeve lidhur me fushën e studimit të programit në gjuhën shqipe. Kjo gjë evidentohet edhe në RVB, fq. 43 si dhe Syllabuset, ku për një pjesë të lëndëve stafi mësimdhënës ka përgatitur Cikël Leksionesh në mungesë të librave. Ekspertët janë të mendimit që institucioni duhet të pasurojë bibliotekën institucionale me blerje të literaturës bazë të detyruar për lëndët e programit të studimit, përtej Ciklit të Leksioneve të përgatitura nga pedagogët.

### ***Komenti i IAL***

*Duke qënë se për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi literatura më e përditësuar disponohet në gjuhën angleze, pedagogët krahas literaturës dhe tekstit bazë kanë detyrimin që të vendosin në dispozicion edhe një cikël leksionesh të shkurtuar, përbledhur për tju ardhur në ndihmë për lehtësi të përvetësimit të njohurive nga studenti. Për të përditësuar literaturën KUB ka të parashikuar alokimin e fondeve për çdo vit me një buxhet të dedikuar për këtë qëllim.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se biblioteka e institucionit ka literaturë të kufizuar të botimeve lidhur me fushën e studimit të programit në gjuhën shqipe. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## **8. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi III.4 Kriteri 4-5**

Referuar takimit në institucion me stafin si dhe dokumentave të konsultuara, rezulton që KUB alokon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore, por ndërkohë botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta. Arritjet në kërkimin shkencor të stafit të Departamentit janë pjesë e raportit vjetor.

Institucioni mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.

Gjithashtu KUB i ofron stafit mundësinë e trajnime të ndryshme nëpërmjet DEI dhe Institutit për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB).

Megjithatë duke konsideruar që 6 nga pedagogët të cilët mbulojnë ngarkesën akademike në këtë program për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktore, GVJ sugjeron që institucioni të shohi mundësitë apo të lidhi marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit për kualifikimin e mëtejshëm të stafit dhe të fillimit sa më të shpejtë të tyre të studimeve doktorale në fushat e tyre përkatëse. Gjithashtu ekspertët rekomandojnë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit.

### ***Komenti i IAL***

*KUB në vijimësi mbështet në forma të ndryshme kualifikimin dhe botime të stafit apo pjesëmarrjet e tij në konferenca dhe aktivitete të tjera kërkimore shkencore.*

### **Argumentimi i GVJ**

GVJ konstaton në RVJ se botimet e stafit akademik te programit në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit, janë të pakta. Për sa më sipër, vlerësimi nuk ndryshon.

## **9. Paragrafi në draft RVJ**

### **Standardi V.4 Kriteri 5**

Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, GVJ konstaton se KUB harton raporte analitike për cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje. Këto raporte janë në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në shërbim të njëjësive dhe drejtuesve të institucionit për të realizuar analizat vjetore.

Këto raporte gjenden në dokumentat: “Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, transferimi i studimeve”; “Raporti mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Viti Akademik 2019-2020”; “Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional”.

Përsa i përket nivelit të punësimit të studentëve të diplomuar në programet e ndryshme të studimit, është Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ajo që merret me mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar, realizimin e anketave për studentët e punësuar dhe hartimin e raporteve për nivelin e punësimit. Të dhënat gjenden në dokumentin “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB”. Ky raport përmban kryesisht të dhëna përshkruese për përqindjen e punësimit të studentëve në profesion ose jo, të vetpunësimit, ose përqindjen e atyre që nuk janë punësuar ende, por nuk paraqitet ndonjë tregues ose analizë për shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe masat që duhen marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. GVJ sugjeron zgjerimin e treguesve të marrë prej pyetsorit dhe një analizë më të detajuar të të dhënave të përfituara prej tij.

Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, akoma nuk ka tregues të nivelit të punësimit të studentëve meqënëse këtë vit akademik diplomohet brezi i parë.

#### ***Komenti i IAL***

*Standardi V.4 Kriteri 5, fq. 60; Lidhur me raportin e punësimit të studentëve KUB është bërë pjesë e platformës GRADUA, i cili financohet nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, që do të mbështesë universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë - ofertë punësimi, të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve sipas treguesve statistikorë jo vetëm përshkrues.*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ merr në konsideratë komentin e IAL për Standardin V.4, Kriteri 5 dhe vlerëson përfshirjen e KUB në platformën GRADUA e cila do ti ndihmojë ata në krijimin e një modeli të integruar kërkesë – ofertë të punësimit të të diplomuarve në programet e ndryshme të studimit. Megjithatë sugjerimi i GVJ në këtë kriter lidhet me studimin e tregut që realizon vetë IAL. Për këtë arsye GVJ i qëndron mendimit të shprehur në RVJ në lidhje me këtë kriter, kështu që RVJ nuk ndryshon.

### **10. Paragrafi në draft RVJ**

#### **Standardi VI.4 Kriteri 3**

Gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC, GVJ u informua që përgjithësisht anëtarët e saj zgjidhen nga të gjitha njësitë kryesore të KUB, përsa i përket anëtarëve që janë staf akademik. Pra kemi një përfshirje të drejtpërdrejtë të një përfaqësuesi të Fakultetit të Ekonomisë, që është Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Aktualisht në përbërjen e NJSBC janë 7 anëtarë nga të cilët 3 janë nga Fakulteti i Ekonomisë, ku 1 prej tyre është pedagog i Departamentit të Ekonomisë dhe Informatikës.

Gjithashtu në porcesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë të përfshirë edhe pedagogët dhe studentët, me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre të cilat jepen me anë të anketimeve por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë.

#### **Standardi VI.4 Kriteri 5**

Përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, KUB e ka përcaktuar në Rregulloren e NJSBC si dhe në Statutin e tij, një anëtar i së cilës është ekspert i jashtëm.

Gjithashtu GVJ konstaton bashkëpunimin e KUB me kompani të jashtëme, për të realizuar kontrolle të pavaruara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë si në aspektin akademik por edhe atë të qëndrueshmërisë financiare. Ndër to mund të përmendim:


- Tirana Business Research Center (TRBC)
- Instituti për Cilësi dhe Arsim (IQE)
- Grand Thorton

#### ***Komenti i IAL***

*Standardi VI.4 Kriteri 3 dhe 5, fq. 66-67; Për një vlerësim sa më objektiv të cilësisë të shërbimeve për mësimdhënien dhe stafin akademik dhe administrativ, KUB angazhon dhe kontraktin institute të pavarura që i konsiderojmë një vlerë të shtuar për institucionin, gjetjet e të cilave përcillen deri në njësitë bazë.*

#### **Argumentimi i GVJ**

GVJ thekson se e ka vlerësuar në Standardin VI.4 Kriteri 3 dhe 5 angazhimin e instituteve të pavarura që ka përfshirë KUB për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe në bazë të argumentave dhe dokumentacionit ka vlerësuar përmbushjen e këtij standardi plotësisht. Për sa më sipër GVJ mendo që RVJ nuk ndryshon.



## Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Biznesi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Kolegji Universitar i Biznesit (KUB), synon të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit si dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kombëtare akademike dhe kulturore.</p> <p>Kjo gjë shprehet qartë në Statutin e KUB neni 4 pikat a-f ku theksohet se:</p> <p><i>“KU “I BIZNESIT” ka për mision të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li><i>a. formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standarteve të demokracisë në vend;</i></li><li><i>b. krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarisë inovative e profesionale për fushën e Ekonomisë, Drejtësisë, teknologjisë së informacionit, si dhe fushave profesionale teknike dhe administrative;</i></li><li><i>c. ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;</i></li><li><i>d. integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;</i></li><li><i>e. nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë;</i></li><li><i>f. krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me Standartet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar objektiva të procesit të Bolonjës.”</i><p>Vizioni dhe Misioni i përcaktuar në Strategjinë e zhvillimit të Kolegjit Universitar “të Biznesit” si për periudhën 2015-2020, ashtu edhe për periudhën 2021-2026, janë në të njëjtën linjë me Statutin e KUB.</p><p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e KUB si dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të “Ekonomisë”(FE) dhe Departamentit të “Ekonomiksit dhe Informatikës” (DEI) ku ai bën pjesë.</p><p>Referuar rregullores së këtij program studimi, neni 3, ky program ka për qëllim “të përgatisë specialistë të fushës së informatikës së biznesit, të specializuar ndaj shërbimeve të informatizuara të ekonomisë në sektorin privat dhe publik, të edukuar me njohuritë e</p></li></ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	

	<p>nevojshme shkencore, teknike dhe profesionale, për të njohur ekonominë, informatikën, tregun dhe problematikat përkatëse dhe të jenë të aftë për të zgjidhur problemet e fushës përkatëse të profesionit, në cdo mjedis ekonomik ku ata do të punojnë” (fq.2). Po në këtë nen të rregullores, pikat 1-3, evidentohen ndër objektivat kryesorë të jenë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. “t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e ture si specialistë në fushën e informatikës së biznesit;</li> <li>2. njohuri të specializuara në gjuhët bazë të programimit, informatikës së biznesit;</li> <li>3. aftësi për përdorimin, përpunimin dhe analizën e informacioneve specifike të fushës së punës;”</li> </ol> <p>Evidenca:  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 3. Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2015-2020.pdf  Dok. 3.1 Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në Strategjinë e Zhvillimit të KUB për periudhën 2021-2026 theksohet se “Vizioni i KUB-it fokusohet te shndërrimi i këtij institucioni të arsimit të lartë në një IAL të nivelit të lartë duke synuar mënyrën e të menduarit globalisht dhe kultivuar vetëdijen kozmopolite si dhe duke nxitur një kulturë të re dhe inovative të të nxënit.” (fq.4).
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Drejtimit prioritar të KUB janë paraqitur qartë në Statut, neni 4, pika b, ku theksohet se institucioni ka për mision të “krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarisë inovative e profesionale për fushën e Ekonomisë, Drejtësisë, teknologjisë së informacionit, si dhe fushave profesionale teknike dhe administrative”.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Referuar dokumentave strategjike të KUB si Statuti, Strategjitë e Zhvillimi, Rregullore, si dhe nga vizita në institucion, GVJ konkludon se: programi i studimit Bachelor në IB është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritar akademike të institucionit. Emërtimi, organizimi, struktura si dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe objektivat e zhvillimit si institucional ashtu

	<p>dhe të FE dhe DEI. Në të janë përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë njohuritë, formimin dhe aftësitë që marrin në përfundim të programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf</p> <p>Dok. 3. Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar "I Biznesit" 2015-2020.pdf</p> <p>Dok. 3.1 Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar "I Biznesit" 2021-2026.pdf</p> <p>Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</p> <p>Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.pdf</p> <p>Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi bachelor në IB ka të përcaktuara qartë në rregulloren e tij objektiva lidhur me formimin e studentëve referuar dijeve, aftësive si dhe kompetencave profesionale që duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit të cilat karakterizojnë profilin e këtij programi. Këto objektiva pasqyrohen në nenin 3, faqe 2, të kësaj rregullorjeje si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>"t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e informatikës së biznesit;</i></li> <li>2. <i>njohuri të specializuara në gjuhët bazë të programimit, informatikës së biznesit;</i></li> <li>3. <i>aftësi për përdorimin, përpunimin dhe analizën e informacioneve specifike të fushës së punës;"</i></li> <li>4. <i>njohuri informatike dhe financiare me qëllim rritjen e efikasitetit në biznes;</i></li> <li>5. <i>aftësi për zbatimin e sistemeve të avancuara teknologjike për biznesin;</i></li> <li>6. <i>dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e informatikës së biznesit dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë.</i></li> </ol> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për</p>	<p>KUB ka kryer një studim mbi tregun lokal të përpara hapjes së programit bachelor në IB. Në këtë material KUB ka raportuar fillimisht informacione lidhur me programin e studimit si: Misioni, Vizioni,</p>

<p>programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Objektivat e Qëllimi i programit të studimit. Më pas studimi vijon me një analizë të shkurtër të tregut të punës dhe mundësive të tij, por kjo analizë nuk është mbështetur me evidenca nga të dhëna dytësore apo parësore, megjithëse në punim raportohet për një anketim të bërë në vitin 2016, por asnjë detaj lidhur me këtë pyetësor nuk është raportuar. <i>Për sa më sipër GVJ konkludon se metodologjia mbi të cilën është ndërtuar ky studim tregu, nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga tregu. Ekspertët gjithashtu rekomandojnë që studimi i tregut të shtrihet jo vetëm në mundësitë dhe nevojat e tregut të brendshëm por edhe të atij jashtë Shqipërisë.</i></p> <p>Megjithëse ky program ende nuk i ka ofruar tregut të diplomuarit e parë, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, KUB në mënyrë periodike realizon kontakte me studentët pas diplomimit me qëllim gjurmimin e punësimit të tyre. Ndërkohë Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë realizon kontakte dhe marrëveshje të vazhdueshme me punëdhënësit, lidhur me kërkesat dhe nevojat e tyre si dhe për të mbështetur procesin e realizimit sa më të mirë të programit mësimor, për të kryer sa më mirë praktikat profesionale si dhe për të mundësuar punësimin e studentëve. Gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatuan se tre prej studentëve të vitit të tretë të programit bachelor në IB, kishin marrë oferta punësimi nga kompanitë ku ato kishin kryer praktikën profesionale. KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani biznesi, OJF, si dhe institucione publike.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit Informatikë Biznesi.pdf</p> <p>Dok. 81. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB.pdf</p> <p>Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit bachelor në IB, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



<b>Standardi I.4</b>				
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	KUB është i organizuar në dy fakultete: (1) Fakulteti i Ekonomisë; dhe (2) Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale. Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre departamente: (1) Departamenti i Financë Kontabilitetit; (2) Departamenti i Menaxhimit; si dhe (3) Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. Programi Bachelor në “Informatikë Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, i cili përtej këtij programi ofron edhe një program tjetër bachelor në Teknologji Informacioni. Programi i studimit Bachelor në IB, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DEI si dhe të FE, dhe i shërben misionit që ato mbartin.			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar RVB, si dhe Dok. 20 “Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit Vitet Akademike 20180-2021” rezultoi se DEI ka të angazhuar 14 pedagogë për vitin akademik 20220-2021, nga të cilët 7 janë personel akademik efektiv dhe 7 janë me kontratë, ndërkohë mbi 70% e ngarkesës së programit mbulohet nga stafi efektiv, duke përbushur kushtin ligjor (VKM nr. 418, datë 10.05.2017). 3 nga 7 anëtarët e personelit akademik efektiv mbajnë gradën shkencore doktor.			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Nga sa më sipër GVJ konkludon se, programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” operon në kuadër të kornizave ligjore dhe ligjit të arsimit të lartë 80/2015. Ky program është në përputhje me nivelin 6 të kornizës evropiane dhe shqiptare të kualifikimit. Strukturat operacionale të institucionit mundësojnë arritjen e misionit të KUB si edhe përbushjen e objektivave të tij. Evidenca: Dok. 22. Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve që ofrohen në FE.pdf Dok. 3.1 Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026.pdf Dok. 20. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit Vitet Akademike 2018-2021.pdf Dok. 21. Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik të stafit akademik të programit të studimit IB.pdf			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.5**  
**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Bachelor në “Informatikë Biznesi”, KUB ka përcaktuar si në rregulloret e brendshme institucionale ashtu edhe të DEI ndarje të detyrave dhe përgjegjësiwe midis njësive të ndryshme. Bashkëpunimi i strukturave dhe njësive kryesore brenda institucionit, realizohet në përputhje me nivelin hierarkik të përcaktuar në organigramën e KUB. Duhet theksuar se pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin, DEI, e cila organizon procesin mësimor, bën shpërndarjen e ngarkesave të stafit akademik si dhe bën vlerësimin e ecurisë së tij. Nga dokumentacioni i dorëzuar në sistemin AMS, konstatohet një analizë periodike në rang fakulteti për vitin akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 31. Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>KUB ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit bachelor në IB. KUB bashkëpunon me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si p.sh. Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kolegji Dukagjini, Peje, Kodolanyi Jano University, Hungary, etj. Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për të realizuar praktikant profesional të studentëve, ndër të cilat vlen të përmenden marrëveshjet me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, IT Gjergj Kompiuter, Shoqëria Tregtare “Infosoft Software Developer”, etj.</p> <p>Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorë të biznesit janë në mbështetje të realizimit të veprimtarive të përbashkëta akademike si dhe realizimit të praktikave profesionale. KUB në përfundim të vitit akademik 2020-2021 ka përgatitur një raport analitik ku ka janë evidentuar përfitimet e institucionit nga këto marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Evidenca:</p> <p>Dok. 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.pdf  Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Evidenca:</p> <p>Dok. 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.pdf  Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf</p>

	Dok. 28. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.pdf			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Që nga viti 2014, KUB ka themeluar Institutin për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), i cili funksionon si një organizatë jofitimprurëse me statusin e një qendre studimore dhe trajnimesh. Nëpërmjet këtij insitutti, KUB realizon trajnime për edukimin e vazhduar gjatë gjithë jetës, të specialistëve, ekspertëve dhe profesionistëve përmes trajnimeve dhe kualifikimeve për rritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës profesionale, përgatitjen e profesionistëve për dhënien e provimeve të shtetit pranë strukturave të Ministrisë së Financave, për specialistët të interesuar në fitimin e titujve profesionalë si Kontabël i Miratuar apo Auditues Ligjor. Evidenca: Dok. 48. Informacion për Institutin për Studime dhe Aplikime në Biznes, vendimi i gjykatës për hapjen.pdf Dok. 48.1 Aplikimi për zgjerimin e fushës së trajnimeve të ISAB.pdf Dok. 48.2. Program trajnimi i realizuar nga ISAB.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznes”, rezulton të jetë i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, ekspertët konstatojnë se programi Bachelor në IB është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Studentit i ofrohen nga 11 lëndë gjatë vitit të parë akademik, 10 lëndë gjatë vitit të dytë, ndërsa në vit të tretë 9 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Diploma (Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit).</p> <p>Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në IB, synon t’u ofrojë studentëve një formim të gjerë në llojshmëri të profesionit e specialiteteve në fushë e Informatikës së Biznesit si në sektorin publik ashtu edhe atë privat e jofitimprurës. Nëpërmjet lëndëve si Programim, Strukturë të Dhënash, Database dhe Menaxhim, Statistikë Biznesi, Modelim Biznesi, Financë, Makroekonomi, Kontabilitet, etj, ky program pajis studentët me njohuri të specializuara në gjuhët bazë të programimit, aftësi për përdorimin, përpunimin dhe analizën e informacioneve, aftësi për zbatimin e sistemeve të avancuara teknologjike, aftësi për analiza të ndryshme të biznesit.</p> <p><i>Përtej këtyre lëndëve GVJ është i mendimit se institucioni duhet të ofrojë edhe lëndë operationale si Menaxhim Operationesh apo Kërkim Operationesh me qëllim aftësimin e studentëve drejt analizave sasiore të vendimmarrjes dhe përdorimit të burimeve të organizatës si dhe krijimit të produkteve apo shërbimeve të cilat plotësojnë nevojat e konsumatorëve, duke siguruar efikasitetin dhe efektivitetin.</i></p> <p>Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Pas shqyrtimit të përmbajtjes së Planeve Mësimore, Syllabuseve të lëndëve, Literaturës së miratuar nga departamenti, si dhe takimeve të ndryshme gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, stafin drejtues dhe studentët, GVJ konstaton se programi Bachelor në IB:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- u ofron studentëve njohuri të përparuara në fushën e “Informatikës së Biznesit” nëpërmjet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të kësaj fushe si për kompanitë private, ashtu edhe për ato publike apo organizatat jo fitimprurëse;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara</p>	



<p>në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e ekonomisë, analizës së biznesit, si dhe informatikës e teknologjisë;</li> <li>- përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018:</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- programi është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS me një total prej 180 ECTS; studentit i ofrohen nga 11 lëndë gjatë vitit të parë, 10 lëndë gjatë të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 9 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet instrumentëve të ndryshëm të vlerësimit si: frekuentimi i lëndës, detyrat e kursit, testimet gjatë vitit, provimi përfundimtar;</li> <li>- objektivat formues dhe kompetencat profesionale janë të përcaktuara;</li> <li>- në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë e cila shoqërohet edhe me suplementin përkatës;</li> <li>- ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite; GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë të përcaktuara korrektësisht dhe se lëndët: <ul style="list-style-type: none"> <li>- bazë: kategoria A, përbëjnë 17.8 % të krediteve,</li> <li>-karakterizuese: kategoria B, përbëjnë 54.4 % të krediteve,</li> <li>-integruese: kategoria C, përbëjnë 11.7% të krediteve,</li> <li>-plotësuese: kategoria D, përbëjnë 11.7% të krediteve,</li> <li>-detyrimeve përmbyllëse: kategoria E, përmban 4.4% të krediteve;</li> </ul> </li> <li>- modeli i përdorur për hartimin e Syllabuseve është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. <i>Por ndërkohë ekspertët konstatojnë se në syllabuse nuk është i përcaktuar kodi i lëndës. GVJ rekomandon që institucioni të unifikojë paraqitjen e lëndëve me emërtimet dhe kodet përkatëse në syllabuse.</i></li> </ul>
	<p>Evidenca:</p> <p>Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf</p> <p>Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p> <p>Dok. 3.1 Strategjia e zhvillimit të Kolegjit Universitar “I Biznesit” 2021-2026.pdf</p> <p>Dok. 14.4. Kategorizimi i lëndëve sipas Veprimtarive Formuese të programit të studimit IB.pdf</p> <p>Dok. 51. Format e Kontrollit të Njohurive .pdf</p>

	Dok. 55. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga dekani .pdf Temat dhe udheheqesit e diplomes.pdf Kompanite ku studentet kryejnë Praktiken Mesimore.pdf Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf Dok. 15. Modeli i diplomës, Modeli i Supplementit të Diplomës.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.2</b> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB), është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe riorganizuar me Urdhër Nr. 39, datë 31.01.2018. KUB është akredituar institucionalisht, sipas VBA-ASCAL, Nr. 53, të datës, 27.11.2020. Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është hapur me UMASR Nr. 392, datë 10.07.2018, veprimtaria akademike e të cilit ka filluar në vitin akademik 2018-2019.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	KUB ka emëruar në rolin e koordinatorit të programit të studimit Bachelor në IB, një përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale tij, por <i>GVJ konstaton se stafi akademik i emëruar është i punësuar në institucion me kontratë dhe jo me kohë të plotë. Emërimi në këtë pozicion kyc të programit i një personeli akademik jo efektiv mund të jetë pengesë e përmbushjes me efektivitet të detyrave të këtij pozicioni. Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët, rezultoi që për problemet në mbarëvajtjen mësimore studentë kontaktonin me sekretarinë e fakultetit, ndërkohë që kjo mbarëvajtje duhet të mbikëqyret dhe koordinohet nga koordinatori i programit. Ekspertët janë të mendimit që institucioni në këtë pozicion duhet të emërojë një personel akademik efektiv.</i> Evidenca: Dok. 29. Urdhri për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf Dok. 24. Lista e stafit Akademik miratuar në Senatin Akademik të KUB.pdf
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Ekonomisë është i organizuar në tre departamente: (1) Departamenti i Financë Kontabilitetit; (2) Departamenti i Menaxhimit; dhe (3) Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës. Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës ofron studime në dy programe të ciklit të parë bachelor në: (1) Informatikë Biznesi; dhe (2) Teknologji Informacioni.
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për	Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin Bachelor në IB, janë të përcaktuara në Statut, në Rregulloren e KUB si dhe në Rregulloren e




numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<p>Departamentit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë.</p> <p>Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës ka gradën shkencore, “Doktor”.</p> <p>FE ka në përbërje të tij për vitin akademik 2020-2021, 21 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE) ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore /titull akademik.</li> <li>- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 4 janë me gradë shkencore /titull akademik.</li> <li>- Departamenti i Menaxhimit ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore</li> </ul> <p>Përsa më sipër GVJ konstaton se të tre departamentet plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik jo vetëm për vitin akademik 2020-2021, por edhe vitet e mëparshme akademike, respektivisht 2019-2029, 2018-2019.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 22. Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve që ofrohen në FE.pdf</p> <p>Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf</p> <p>Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf</p> <p>Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</p> <p>Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.pdf</p> <p>Dok. 19. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Përgjegjëse.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar, RVB, evidencave të dorëzuara si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë kanë informacionin e duhur (rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve, etj.) për organizimin e programit Bachelor në “Informatikë Biznesi”.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe konsultuar, ekspertët konstatojnë se programi Bachelor në “Informatikë Biznesi” është i organizuar në 6 semestra me një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë


përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 180 ECTS. Studentit i ofrohen nga 11 lëndë gjatë vitit të parë, 10 gjatë vitit të dytë akademik, ndërsa në vit të tretë 9 lëndë ku janë të përfshira Praktika Mësimore si dhe Provimi Përfundimtar ose Teza e Diplomimit.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” përmban të gjithë informacionin e duhur për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Kriteret e pranimit që duhet të përmbushin studentët, janë të përcaktuara në Rregullon e këtij DEI neni 21 dhe Rregulloren FE neni 26, ndërkohë kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve ndërmjet të të njëjtit cikël si brenda KUB apo nga institucione të tjera përcaktohen në Rregulloren për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, Rregulloren e FE neni 32-33 si dhe në Rregulloren e DEI neni 27-28. Evidenca: Dok. 87. Kuotat e pranimeve për vitin akademik 2021-2022.pdf Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë dhe Informatikës.pdf Dok. 56. Rregullore për njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve në KUB.pdf
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Secila lëndë e programi të studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” shoqërohet me syllabusin përkatës. Gjatë analizës së Syllabuseve, GVJ konstatoi se modeli i përdorur për hartimin e tyre është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar; Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në	Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton ndryshimet që janë bërë krahasuar me planin mësimor të liçencuar në programin Bachelor në IB vijojnë si më poshtë:





fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 lëndë ndryshime në ECTS nga viti i parë i studimit (4 ECTS ndryshime);</li> <li>- në 6 lëndë (1 e vitit të parë, 3 të vitit të dytë dhe 2 të vitit të tretë) bëhen ndryshime midis semestrave, duke kaluar nga semestri i parë në të dytë apo anasjelltas. Në këto lëndë nuk ka ndryshime në ECTS.</li> <li>- ndryshime të tjera të vogla rezultojnë në disa lëndë lidhur me rritjen apo uljen e orëve në auditor, të cilat nuk kanë ndikim në përlogaritjen e ECTS-ve.</li> </ul> <p>Ndryshimi total në ECTS rezulton të jetë 2%, brenda kufirit të lejuar prej 20%.</p> <p>Evidenca: Dok. 14.6. Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e studimit IB të licensuar.pdf</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="638 627 798 705">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="798 627 1013 705">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1013 627 1204 705">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1204 627 1442 705">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ referuar dokumentave të dorëzuar konstaton se ngarkesa e programit të studimit Bachelor në IB është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi ku program është i organizuar në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- 180 ECTS;</li> <li>- 6 semestra, 2 në çdo vit;</li> <li>- Çdo semestër zgjat 15 javë mësim dhe mesatarisht 2-4 javë provime</li> <li>- Çdo vit akademik ka 750 orë, 300 orë në auditor, 450 orë jashtë auditorit</li> <li>- Çdo vit akademik ka në total 1500 orë të shpërndara në auditor si leksione e seminare dhe studime individuale:</li> </ul>				
	<b>Auditor</b>			<b>Individuale</b>	<b>Total</b>
	<b>Leksione</b>	<b>Seminare</b>	<b>Praktike</b>		
<b>Viti I</b>	330 orë	287 orë		883 orë	1500 orë
<b>Viti II</b>	345 orë	286 orë		869 orë	1500 orë
<b>Viti III</b>	130 orë	410 orë	80 orë	880 orë	1500



					orë
	805 orë	983 orë	80 orë		
<b>Total</b>	1868 orë		2632 orë	4500 orë	
	<p>- Ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 orë/50 minuta secila</p> <p>Evidenca:  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf  Dok. 14.5. Struktura Mësimore vjetore për Vitin Akademik 2020-2021.pdf</p>				
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- emërtimi i programit, përmbajtja e veprimtarive, dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe punësim të studentëve;</li> <li>- shpërndarja në vite e semestra e lëndëve/ moduleve, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional;</li> <li>- struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor;</li> <li>- ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve;</li> <li>- vlen të përmendet se ky program ka mundësuar mobilitetin e një studenti gjatë vitit akademik 2020-2021, ndërkohë që marrëveshje të tjera mobiliteti janë në proces, si dhe tre studentë kanë marrë propozime për punësim nga institucionet ku kanë kryer praktikën profesionale.</li> </ul>				
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.					
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.					
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Evidenca:  Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf  Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p>				
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p><i>Gjatë analizës së syllabuseve ekspertët konstatojnë se në pjesën më të madhe të lëndëve viti i botimit të literaturës bazë të detyrueshme është relativisht e vjetëruar, ndërkohë që VKM 41 konsideron literaturën e 5 viteve të fundit. GVJ rekomandon që institucioni të rishikojë dhe rinovojë literaturën me atë të 5 viteve të fundit.</i></p>				

	Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	GVJ konstatoi se përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në tregun e punës. Institucioni gjithashtu ka bërë aplikimin për hapjen e një programi të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”.			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf Dok. 70. Aplikimi i hapjes së programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Informatike”.pdf			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Gjatë vizitës në institucion ekspertët konstatuan se Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është në kontakt të vazhdueshëm me aktorë të ndryshëm të tregut me synim rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit për të integruar të diplomuarit në tregun e punës por edhe me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit si dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat që ky treg ka.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Për realizimin e programit bachelor në IB gjatë vitit akademik 2020-2021 janë të angazhuar 13 pedagogë si PAE dhe 11 pedagogë me kontratë (PAK). Për sa i përket kualifikimeve të PAE: - 6 pedagogë mbajnë gradën Dr; - 1 pedagog është në proces doktorature; - 5 pedagogë kanë kualifikimin MSc.; - 1 pedagog ka kualifikimin MP.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, programi: - përmbush kërkesën ligjore që stafi akademik efektiv mbulon të paktën 70% të ngarkesës mësimore, përkatesisht për vitin akademik 2020-2021 me 74% (VKM 418, Maj 2017). - përmbush kërkesën ligjore e të pasurit së paku kualifikimin e një cikli pasardhës për të gjithë stafin akademik që mbulon programin akademik; - niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e	

<p>përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, Megjithatë duke konsideruar që 6 nga pedagogët të cilët mbulojnë ngarkesën akademike në këtë program për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktorature, <i>GVJ sugjeron që institucioni të shohi mundësitë apo të lidhi marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit për kualifikimin e mëtijshëm të stafit dhe të fillimit sa më të shpejtë të tyre të studimeve doktorale në fushat e tyre përkatëse.</i> Evidenca: Dok. 58. Plani Mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës .pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas si dhe institucione publike në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Departamenti gjithashtu ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës. Evidenca: Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf Dok. 46. Udhëzues për Praktikën Profesionale.pdf Dok. 46.1. Programi i praktikës profesionale të Programit Informatikë Biznesi.pdf Dok. 46.2. Raporti i Praktikës Mësimore.pdf Dok. 47. Udhëzues për Përgatitjen e Diplomës.pdf Dok. 55. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga dekani .pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Laboratori informatik është vënë nga institucioni në funksion të studentëve të programit Bachelor në IB për të mundësuar formimin praktik të tyre. Në punët laboratorike të lëndëve si Struktura të Dhnënash; Informatikë; Programim; Informatikë dhe Aplikime Kompjuterike; Database dhe Menaxhim etj, studentët krahas pedagogut të lëndës asistohen edhe nga stafi ndihmës akademik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli ndihmës mësimor shkencor është i angazhuar për realizimin e orëve mësimore, mirëmbajtjen dhe funksionimin e laboratorëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht <b>X</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni në fillim të vitit akademik 2020-2021, ka hartuar një plan masash rreth zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative për mësimdhënien gjatë pandemisë, e cila qe gjithashtu edhe një kërkesë e detyrueshme nga MASR. Për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor, KUB gjithashtu ka përgatitur guidë për përdorimin e platformës Classroom si për stafin ashtu edhe për studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 76. Plani i masave KUB, 2020-2021.pdf</p> <p>Dok. 39. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom.pdf</p> <p>Dok. 54. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom.pdf</p> <p>Dok. 60. Rregullore “Për procedurën e mësimdhënies online, në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), në kushte situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore”.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe takimeve gjatë vizitës me drejtuesit e institucionit, drejtuesin dhe stafin e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), ekspertët konstatojnë si mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik në programin Bachelor në Informatikë Biznesi.</p> <p>Institucioni realizon vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Implementimit të “Pyetësor të Vlerësimit të Procesit Mësimor” nga ana e studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e të cilit përpunohen nga NJSBC dhe paraqiten nëpërmjet titullarit të institucionit për diskutim në Senatën akademik, i cili bën vlerësimin dhe cakton detyrat për masat që duhen marrë për të garantuar plotësimin e standarteve dhe cilësisë në institucion. Ky pyetësor plotësohet nga studentët në fund të semestrit përpara provimeve duke iu drejtuar në formë fizike të printuar ose në formë elektronike duke iu drejtuar në adresat e tyre personale.</li> <li>- Intervistave me kampion studentësh nga cdo program studimi.</li> <li>- Implementimit të “Pyetësor për Mbledhjen e Opinioneve të Stafit Akademik për Procesin Mësimor”, drejtuar stafit akademik dhe ndihmës akademik.</li> <li>- Analizës semestrale të FE mbi arritjet e objektivave formuese të programit të studimit.</li> <li>- Raportit përmbledhës vjetor të NJSBC mbi vlerësimin e cilësisë së brendshme, i cili bëhet edhe publik në faqen web të</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e</p>	

<p>mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>institucionit (<a href="http://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/">http://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/</a>).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi në rang fakulteti të performancës vjetore të stafit të brendshëm lidhur me angazhimin në mësimdhënie, udhëheqje diplome, ndjekje praktikash mësimore, artikuj të botuar në revista dhe konferenca shkencore, angazhime në grupe kërkimore, angazhime në projekte si dhe angazhime administrative e të tjera.</li> </ul> <p>KUB nëpërmjet rregullores së tij, u garanton gjithashtu studentëve të drejtën e ankimimit për rezultatet e vlerësimit të dijës. Institucioni u ka vënë në dispozicion studentëve një kuti të posaçme për adresimin e ankimeve dhe shqetësimeve.</p> <p>Përtej angazhimit dhe raporteve periodike të NJSBC, KUB angazhon edhe agjensi të jashtme të pavarura me qëllim vlerësimin sa më real dhe të paanshëm të cilësisë në institucion. Këtë vit akademik është zhvilluar edhe një pyetësor për stafin akademik dhe studentët nga Instituti për Cilësi në Arsim (IQE), në raportin e të cilit janë evidentuar edhe stafi akademik më i votuar nga studentët. KUB nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 7. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf  Dok. 78. Tip pyetësor studenti nga IQE.pdf  Dok. 78.1 Tip pyetësor stafi akademik nga IQE.pdf  Dok. 78.2. Raportet e Pyetësorit të stafit IQE.pdf  Dok. 78.3. Raportet e Pyetësorit të studentëve IQE.pdf  Dok. 30. Plani i Punës së NjsBC për Vitin Akademik 2020-2021.pdf  Dok. 77. Format i Vlerësimit të performancës së Stafit të KUB.pdf  Dok. 33. Pyetësori i studentëve.pdf  Dok. 34. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf  Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjsBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf  Dok. 30.2. Raport mbi kontrollin e syllabusit për modulën.pdf  Dok. 30.3. Raport mbi kontrollin për procesin mësimor online.pdf  Dok. 30.4. Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf  Dok. 31. Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton nëpërmjet planit mësimor të programit Bachelor në “Informatikë Biznesi” si dhe takimeve me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion, se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive të përdora janë leksione/seminare/detyra grupi/detyra kursi. Stafit akademik i KUB u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në varësi të lëndës/modulit, me synim konkretizimin e anës praktike dhe përmirësimin e aftësive programuese dhe përpunuese të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Në planin mësimor, në total rezultojnë orë mësimore në auditor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione 805 orë mësimore</li> <li>- Seminare 983 orë mësimore</li> <li>- Praktika profesionale 80 orë praktikë në terren</li> <li>- Gjithsej në auditor 1868 orë mësimore</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivate formues.</p> <p>Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar planit mësimor për programin e studimit bachelor në Informatikë Biznesi, CV-ve të stafit akademik, Syllabuseve, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas lëndëve/modulit dhe tematikave të tyre. Gjithashtu KUB ka vënë në dispozicion të stafit akademik mjete bashkëkohore të mësimdhënies si ato audio-vizive, smartboard, laboratorë, etj.</p> <p>Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf Dok. 18. CV e stafit akademik të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të zhvilluara me stafin mësimdhënës dhe studentët konstaton se institucioni nxit zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër”. Gjithashtu, ekspertët konstatojnë se personeli akademik:</p>

reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor metoda interaktive dhe diskutimi, për ta bërë sa më tërheqëse orën e mësimit;</li> <li>- vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimit, duke reflektuar mendimet e sugjerimet e studentëve të paraqitura në vlerësimet periodike të studentëve;</li> <li>- nëpërmjet metodave të mësimit mundohen të inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</li> </ul>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.				
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Evidenca:</p> <p>Dok. 30. Plani i Punës së NjSBC për Vitin Akademik 2020-2021.pdf</p> <p>Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjSBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësinë profesionale duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga njësi bazë si dhe inspektimit të ambienteve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KUB ka vënë në dispozicion të programit Bachelor në "Informatikë Biznesi" në ambientet e godinës A: 11 salla për zhvillimin e leksioneve, 6 salla për zhvillimin e seminareve si dhe 1 laborator për zhvillimin e lëndëve aplikative. Ndërkohë në ambientet e godinës B ka vënë në dispozicion të programit: 10 salla për zhvillimin e leksioneve, 5 salla për zhvillimin e seminareve si dhe 1 laborator për zhvillimin e lëndëve si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj.</li> <li>- Hapësirat janë të mjaftueshme, me ndriçim dhe ajrosje dhe mirëmbahen e pastrohen nga stafi ndihmës i institucionit;</li> <li>- Janë funksionale dhe çdo sallë është e pajisur me videoprojektor, laptop dhe tabelë të bardhë apo smartboard;</li> <li>- Studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas,</li> <li>- Kanë në përdorim platformën dixhitale "Google Meet" për takimet dhe mësimet online si dhe "Classroom" ku studenti mund të aksesojë materialet e lëndës.</li> <li>- Në dispozicion të institucionit është një personel i strukturës së teknologjisë së informacionit</li> </ul> <p>Evidenca:</p>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	



	Dok. 35. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (salla, laboratorë, studio, atelie, hapësirat ndihmëse).pdf
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë analizës së Syllabuseve, GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.  Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi hapësirat e bibliotekës së institucionit janë komode, <i>por biblioteka ka literaturë të kufizuar të botimeve lidhur me fushën e studimit të programit në gjuhën shqipe. Kjo gjë evidentohet edhe në RVB, fq. 43 si dhe Syllabuset, ku për një pjesë të lëndëve stafi mësimdhënës ka përgatitur Cikël Leksionesh në mungesë të librave. Ekspertët janë të mendimit që institucioni duhet të pasurojë bibliotekën institucionale me blerje të literaturës bazë të detyruar për lëndët e programit të studimit, përtej Ciklit të Leksioneve të përgatitura nga pedagogët.</i>  Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf Dok. 35.4. Tituj në Bibliotekën e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ konstaton se KUB në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, u mundëson personelit akademik dhe studentëve aksesimin pa pagesë të librave on-line të fushave të ngjashme apo të përafërta me programin e studimit bachelor në Informatikë Biznesi.  Evidenca: Dok. 35.1. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (platformat online - struktura e teknologjisë së informacionit, Biblioteka - Biblioteka online).pdf Kontrata aktuale për bibliotekën online.pdf
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë vizitës në institucion ekspertët konstatuan se KUB ka vënë në dispozicion të programit bachelor në Informatikë Biznesi dy laboratorë informatike, të cilët shfrytëzohen nga studentët e programit për një pjesë të lëndëve duke përdorur programe specifike në varësi të lëndës. Gjithashtu në dispozicion të studentëve, megjithëse me hapësira të limituara, janë vënë edhe ambientet e bibliotekës në Godinën A, e cila përdoret për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës apo studimeve specifike.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	GVJ gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët konstatoi se studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas. Nëpërmjet përdorimit të platformës dixhitale, pedagogu i lëndës ka mundësinë të ngarkojë në sistem materialet mësimore si leksione, prezantime, detyra dhe komunikime të tjera.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në	Evidenca: Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf

dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.									
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Gjatë takimeve në institucion GVJ konstatoi se për vitin akademik 2020-2021, studentët të cilët kanë përzgjedhur zhvillimin e temës së diplomës janë orientuar, asistuar dhe mbështetur nga pedagogu i tyre udhëheqës. KUB ka hartuar gjithashtu një udhëzues “Për procedurat e përgatitjes së temës për mbrojtje diplome në programet e studimeve të cikli i parë “Bachelor” në IALP”.								
	Evidenca: Dok. 47. Udhëzues për Përgatitjen e Diplomës.pdf Dok. 47.1. Një model komunikimi pedagog-student për udhëheqje diplome.pdf Temat dhe udhëheqësit e diplomes.pdf								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Referuar nenit 81 të Statutit të KUB, Senati Akademik është organi përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. Ndërkohë NJSBC realizon vlerësime periodike për veprimtaritë mësimore, pyetësorët e studentëve dhe të stafit akademik dhe ndihmës akademik, përpunimin dhe analizën e tyre, si dhe vlerësime për veprimtaritë kërkimore shkencore dhe harton raportimin në nivel institucional. Njësi të tjera ndihmës-akademike me karakter administrative në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor janë: - Zyra e kurrikulave, - Zyra e studentit dhe këshillimit të karrierës, Evidenca: Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 7. Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.pdf Dok. 11. Rregullore e Zyrës së Kurrikulës.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se drejtuesi i Njësisë Kryesore, përcaktuar gjithashtu edhe në rregulloren e FE-së (kreu 10, neni 60), është përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor. Ai drejton dhe kontrollon punën mësimore e shkencore të FE, siguron zbatimin e planeve dhe programeve të mësimdhënies si dhe kalendarin akademik të fakultetit. Ai është përgjegjës për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e analizave të punës mësimore në departamente dhe ndjek procedurat e
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin	

<p>eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>vetëvlerësimin në departamente. Ndërkohë departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes si të pedagogëve ashtu dhe të studentëve të këtij programi. Përgjegjësi i departamentit ndjek proceset mësimore e kërkimore në bashkëveprim me stafin e këtij departamenti. Në të njëjtën kohë Dekani i FE në bashkëpunim me përgjegjësin e DEI, sigurojnë përmirësimin e cilësisë së programit Bachelor në IB nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, nxjerrjes së pikave të dobëta dhe paraqitjes së propozimeve për përmirësim të cilësisë në mësimdhënie. Në fund të vitit akademik fakulteti përgatit analizë periodike mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p> <p>Të gjitha strukturat dhe njësitë përgjegjëse të KUB mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në kuadrin e situatës së Covid-19, këto njësi kanë organizuar zhvillimin e leksioneve, seminareve, testeve online nëpërmjet portalit KUB, Platformës Google Classroom dhe Google Meet, si dhe përgatitjen e materialeve të nevojshme dhe publikimin e tyre po në këto portale.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 78. Tip pyetësor studenti nga IQE.pdf  Dok. 78.1 Tip pyetësor stafi akademik nga IQE.pdf  Dok. 77. Format i Vlerësimit të performacës së Stafit të KUB.pdf  Dok. 33. Pyetësori i studentëve.pdf  Dok. 34. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf  Dok. 30.2. Raport mbi kontrollin e syllabusit për modulin.pdf  Dok. 30.3. Raport mbi kontrollin për procesin mësimor online.pdf  Dok. 30.4. Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf  Dok. 31. Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.pdf  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar takimit në institucion me stafin si dhe dokumentave të konsultuara, rezultojnë që KUB alokon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore, <i>por ndërkohë botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta</i>. Arritjet në kërkimin shkencor të stafit të Departamentit janë pjesë e raportit vjetor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu KUB i ofron stafit mundësinë e trajnimeve të ndryshme nëpërmjet DEI dhe Institutit për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB). Megjithatë duke konsideruar që 6 nga pedagogët të cilët mbulojnë ngarkesën akademike në këtë program për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktorature, <i>GVJ sugjeron që</i></p>

	<p><i>institucioni të shohi mundësitë apo të lidhi marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit për kualifikimin e mëtejshëm të stafit dhe të fillimit sa më të shpejtë të tyre të studimeve doktorale në fushat e tyre përkatëse. Gjithashtu ekspertët rekomandojnë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 18. CV e stafit akademik të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 58. Plani Mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës .pdf  Dok. 36.1. Të dhëna të plota të bashkëpunimeve shkencore jashtë KUB-it.pdf  Dok. 48. Informacion për Institutin për Studime dhe Aplikime në Biznes, vendimi i gjykatës për hapjen.pdf  Dok. 48.1 Aplikimi për zgjerimin e fushës së trajnimeve të ISAB.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion si me drejtuesit ashtu dhe me stafin GVJ konkludon se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësitë e stafit akademik dhe ndihmës akademik janë gjithashtu të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në IB.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjithashtu personeli akademik dhe ai ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në departament. Më pas performanca e punës kërkimore si dhe e angazhimeve të tjera e stafit akademik si në nivel departamenti apo individual vlerësohet nga dekanati i FE dhe paraqitet më tej në Rektorat nëpërmjet raportimeve periodike të analizave të punës mësimore e kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 18.1. Kontratë pune, me kohë të plotë.pdf  Dok. 18.2. Kontratë pune, me kohë të pjesshme.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 31. Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive, përcaktohen si në rregulloren e KUB e cila është edhe publike në website të KUB, ashtu edhe në rregulloren Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës dhe të programit studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Të gjitha këto elementë i bëhen të ditura studentëve dhe janë të publikuara në website individual të secilit prej pedagogëve të lëndëve në syllabuset e tyre në Portalin e KUB.</p> <p>Evidenca: Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 4.1. Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik konstatoi se studentët informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për programin e lëndës, format alternative të vlerësimit, dhe detyrimet që ata kanë dhe që janë të parashikuara në Syllabuse.</p> <p>Referuar syllabuseve të lëndëve të programit, GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme të ndërthura (me shkrim; me gojë; detyra kursi; projekte) të përcaktuara nga titullari i lëndës, për ti dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Evidenca:  Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf  Dok. 51. Format e Kontrollit të Njohurive .pdf</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Evidenca:  Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf  Dok. 51. Format e Kontrollit të Njohurive .pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b>  <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve e stafit akademik konkludon se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë semestrit, i cili ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë gjithë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit (si p.sh. detyra individuale, detyra kursi, prezantime, pjesëmarrje në mësim, teste), i cili përbën 40% të vlerësimit total të studentit.</li> <li>2. Vlerësimi përfundimtar në sezonin përkatës i cili përbën 60% të vlerësimit total të studentit.</li> </ol>

	<p>Evidenca:</p> <p>Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p> <p>Dok. 51. Format e Kontrollit të Njohurive .pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>KUB ka në përdorim një platformë elektronike interaktive në funksion të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, Portali KUB, e cila është e integruar me Google Classroom dhe Google Meet dhe mundëson gjithashtu testimin dhe vlerësimin elektronik të studentëve. Kjo platformë është përdorur nga institucioni gjatë periudhës së Covid-19 si për mësimdhënie ashtu edhe për testimin dhe vlerësimin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe dokumentave të aksesuar, GVJ konstaton se testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim i cili realizohet duke shkëputur gjysmën e fletës kapak ku është shkruar përkatësisht emri, mbiemri, lënda, grupi dhe numri ID i studentit. Kjo pjesë e dokumentit mbetet në sekretarinë e fakultet dhe lidhet me pjesën e tezës së provimit me të njëjtin numër natyror progresiv të vendosur para fillimit të provimit po nga sekretaria. Në rastin kur numri i studentëve është më i lartë se 35, përgjegjësi i departamentit cakton edhe një pedagog tjetër mbikëqyrës të provimit përveç pedagogut të lëndës, përcaktuar në nenin 13 të Rregullores për Procedurat e Zhvillimit të Provimit. Pedagogu shman mundësinë e paisjeve kopjuese dhe monitoron vazhdimisht sallën e provimit për të shmanur komunikimin mes studentëve. Institucioni gjithashtu ka investuar në pajisjen me mjete survejimi në të gjithë strukturën e godinave A dhe B me qëllim sigurimin e një procesi normal zhvillimi sezoni provimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Tezat e provimit hartohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me pedagogun që zhvillon seminarët, kur është një rast i tillë. Pasi hartohet, teza e provimit, firmoset nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në korrigjimin e tezave të provimit, pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha plotësimet apo mosplotësimet që lidhen me trajtimin e tezës së realizuar nga studenti dhe vlerësimi kryhet për cdo pyetje për të dalë më tej në vlerësimin përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studenti e merr rezultatin e provimit nëpërmjet portalit të KUB-it, ku Sekretaria Mësimore hedh notat me numër personal ID të studentit jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për cdo paqartësi nga ana e tij, ose të ankimojë rezultatin brenda tre ditëve nga shpallja e tij. Kontestimi bëhet me shkrim pranë sekretarisë mësimore, dhe më pas depozitohen në departament. Pedagogu përkatës i departamentit i shqyrton kërkesat dhe i komunikon sekretarisë qëndrimin dhe vlerësimin e ankimit për ndryshim apo mosndryshim të rezultatit. Kur studenti konteston sërish rezultatin, ankesa përcillet svrish në departament, i cili më pas kërkon shqyrtimin e nga komisioni të ngritura posacerisht. Komisioni më pas përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës, të formës së prerë. Në rast kur vendimi i komisionit është për ndryshim të vlerësimit, njoftohet pedagogu i lëndës për të bërë ndryshimin përkatës, në të kundërt lihet në fuqi vlerësimi fillestar.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në</p>	

përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Evidenca:			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Dok. 4.1. Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve.pdf Dok. 4.2. Model Teze Provimi e Sekretuar.pdf Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit bachelor në “Informatikë Biznesi” ofron një gamë të gjerë të lëndëve të formimit si ekonomik ashtu dhe informatik. Nëpërmjet lëndëve si Ekonomiks; Statistikë; Hyrje në Informatikë; Programim; Organizimi i Sistemit Kompjuterik; Sjellje Konsumatore; Modelim Biznesi; Sociologji-Psikologji; Gjuhë e huaj; etj., synon të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimi dhe ndërveprimit. Evidenca: Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga takimi me pedagogët, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen dhe shqyrtohen si në fillim ashtu dhe në përfundim të çdo lënde. Gjithashtu në seancën e fundit të semestrit cdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë. Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe	Gjatë vizitës dhe takimeve në institucion si me stafin ashtu dhe studentët, ekspertët konstatojnë se personelin akademik gjatë zhvillimit

seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	të mësimi ftojnë personalitete apo specialistë tv fushës me qëllim përcjelljen e njohurive mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë.			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Referuar planit mësimor, syllabuseve, CV-ve të stafit mësimdhënës si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, GVJ konstaton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi për adresimin e sfidave dhe problemeve të biznesit, nëpërmjet rasteve studimore të situatave komplekse të biznesit apo projekteve analitike. Stafit akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, të cilat gjejnë edhe mbështetjen institucionale. Gjithashtu stafi akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Evidenca: Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf Dok. 17.2. Planet Mësimore për programin e studimit IB.pdf Dok. 18. CV e stafit akademik të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.				
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në përfundim të programit të studimit organizohet provimi final ose mbrojtja e diplomës së studentëve. Departamenti shpall brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik temat orientuese për mbrojtjen e diplomës ose pyetjet e provimit të formimit. Udhëheqësi dhe temat e diplomimit miratohen nga Dekani i FE. Kriteret dhe procedurat mbi përfundimin e studimeve janë të përcaktuara në Udhëzuesin e Diplomimit dhe rregulloren bazë të KUB. Studentëve u vihen në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës nga sekretaria mësimore, stafi akademik, si dhe pedagogu udhëheqës i temës së diplomës. Programi i provimit final bazohet në njohuritë e marra gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të	



<p>nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>rëndësisë dhe peshës specifike. Pyetjet hartohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i FE. Studentët informohen mbi bankën e pyetjeve nga sekretaria e cila e publikon atë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Tema e diplomës përgatitet individualisht nga çdo student dhe vlerësimi i bëhet në bazë të kapitujve të përgatitur, numrit të faqeve, apo kriterëve të tjera të përcaktuara në Udhëzuesin e KUB për Provimin e Mbrojtjes së Diplomës. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur. Institucioni gjithashtu asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Si provimi final ashtu edhe mbrojtja e diplomës zhvillohen me gojë studentit vlerësohet me notë. Rezultatet e provimit final u shpallen studentëve në fund të çdo dite provimi nga komisioni i provimit. Për studentët të cilët mbrojnë diplomën, ato vlerësohen nga çdo anëtar i komisionit, dhe si vlerësim final merret mesatarja aritmetike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Evidenca: Dok. 47. Udhëzues për Përgatitjen e Diplomës.pdf Dok. 47.1. Një model komunikimi pedagog-student për udhëheqje diplome.pdf Dok. 55. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga dekani .pdf Dok. 47.2. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me provim formimi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Dok. 47.3. Paketë udhëzues për mbrojtjen e diplomës me temë.pdf</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar, GVJ konkludon se institucioni pajis me diplomë, listë notash dhe suplement diplome të miratuara nga MASR çdo student i cili ka plotësuar detyrimet e programit Bachelor në “Informatikë Biznesi” dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material. Suplementi i diplomës është i hartuar në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar pas depozitimit të një kërkesë nga studentit pranë sekretarisë.</p>

<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FE ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit në formë të shkruar dhe elektronike. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri.</p> <p>Evidenca: Dok. 82. Rregullore mbi funksionimin e arkivës në KUB.pdf Dok. 15. Modeli i diplomës, Modeli i Suplementit të Diplomës.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**


<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe bazuar tek evidencat dhe dokumentat e konsultuara gjatë vizitës në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit (ZBNJAA) është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të KUB. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik efektiv, atë me kontratë dhe atë administrativ. Të dhënat mblidhen dhe administrohen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, si dhe duke u mbështetur tek Rregullorja e Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Neni 36 si dhe Rregullorja e Mardhënieve të Punës të KUB, Neni 7.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore Administratës dhe Arkivit disponon një sërë dokumentash për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin CV, dokumentin e identifikimit, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore, dëshmitë e gjuhëve të huaja, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, librezën e punës, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, librezën shëndetsore, dëshminë e penaltetit, rekomandime, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme, këto dosje përmbanin dokumentacionin e plotë të sipërpërmendur. Dokumentacioni përditësohej çdo vit ose sipas ndryshimeve individuale të dokumentacionit që mund të paraqiste personeli gjatë vitit.</p> <p>Përsa i përket informacionit për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik informacioni mbahet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Evidenca: Dok. 37. Formati i dosjes personale të stafit.pdf Dok. 9. Rregullore e mardhënieve të punës.pdf Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se Institucioni Kolegji Universitar i Biznesit, i harton procedurat e rekrutimit të personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe Kodit të Punës së RSH. Hartimi dhe zbatimi i këtyre procedurave përcatohen në dokumentat bazë të institucionit: Statuti, Neni 44; Rregullorja e Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Neni 45, 54, 55; Rregullorja e Mardhënieve të Punës të KUB, Pjesa II, Neni 7-17. Në këto dokumenta janë përcaktuar: kërkesat e përgjithëshme dhe specifike për</p>

	<p>të qenë punonjës i KUB, procedurat e përzgjedhjes së kandidatit, shpallja dhe procesi i konkurimit, mënyra e vlerësimit, etj. Procedurat për shpalljen e vendeve vakante dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore Administratës dhe Arkivit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në takim me personelin dhe drejtuesit e institucionit, GVJ konstatoi se këto procedura janë të hapura dhe transparente.</p> <p>Evidenca:  Dok. 9. Rregullore e mardhënieve të punës.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  <a href="http://kub.edu.al/open-vacancy">http://kub.edu.al/open-vacancy</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni KUB ka përcaktuar në Rregulloren e Mardhënieve të Punës të KUB, Pjesa II, Neni 8 që “Kërkesat specifike për të qenë punonjës i KUB dhe përshkrimi i punës sipas pozicioneve të punës në përputhje me strukturën organizative, përcaktohen sipas rastit me propozim nga njësia bazë, miratohen nga njësia kryesore dhe aprovohen nga nivelet drejtuese eprore.”</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni i harton procedurat e specifike për rekrutimin e personelit dhe i bën ato publike. Në përputhje me Rregulloren e Kolegjit Universitar “I Biznesit” Neni 45 dhe Statutin Neni 44, punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur publik, në një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Kriteret specifike përcaktohen nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës dhe miratohen nga Rektori. Këto kritere kanë bazë kualifikimet akademike dhe eksperiencën e punës në përputhje me kërkesat e pozicionit vakant.</p> <p>Njoftimet për vendet vakante gjenden (aktualisht edhe në periudhën e hartimit të këtij raporti) edhe në faqen e web-it të institucionit si dhe në mediat sociale të tij. Këto njoftime përmbajnë kërkesat e përgjithëshme dhe specifike, përkatëse sipas vendeve vakante të shpallura.</p> <p>Evidenca:  Dok. 9. Rregullore e mardhënieve të punës.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  <a href="http://kub.edu.al/open-vacancy">http://kub.edu.al/open-vacancy</a>  <a href="http://kub.edu.al/thirrje-per-staf-akademik/">http://kub.edu.al/thirrje-per-staf-akademik/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Institucioni KUB i realizon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel në përputhje me Rregulloren e Mardhënieve të Punës të KUB. Në këtë Rregullore, Neni 9-13 janë përcaktuar procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, mënyra e shpalljes dhe realizimit të konkursit dhe mënyra e vlerësimit.</p> <p>Procesi i konkurimit zhvillohet me 3 faza. Në fazën e parë bëhet kualifikimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të shpallura në përputhje me nevojat e vendit vakant. Këto</p>



përmbajtjen e programit të studimit	<p>kritere janë të përcaktuara nga Departamenti përgjegjës për programin e studimit. Në fazën e dytë zhvillohet një intervistë me gojë dhe një testim me shkrim ose prezantim i një leksioni. Synimi i institucionit është që për kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura të përzgjidhen ata që zotërojnë aftësi shumë të mira profesionale por edhe që kanë aftësi të mira në mësimdhënie dhe komunikimin me auditorin. Komisioni i posaçëm merr vendimin për vlerësimin përfundimtar të kandidatit bazuar në një raport i cili përmban edhe vlerësimin me pikë bazuar tek: rezultatet e testimit për njohuritë profesionale dhe gjuhën e huaj; rezultatet e testimit për formimin e përgjithshëm; të dhënat për kualifikimet shtesë; eksperiencia profesionale; publikimet shkencore, etj. Faza e tretë përfshin nënshkrimin e kontratës së punës për kandidatët fitues.</p> <p>Dosjet e procedurave të rekrutimit të personelit gjenden në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit por edhe pedagogët, GVJ konstatoi se këto procedura janë ndjekur për të gjithë stafin e rekrutuar.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 9. Rregullore e mardhënieve të punës.pdf</p>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="986 918 1212 1046"><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td data-bbox="1212 918 1436 1046"><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td align="center"><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>		<b>X</b>
<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
	<b>X</b>						

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi dhe u njoh me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ. KUB e zhvillon aktivitetin e vet akademik dhe administrativ në dy godina A dhe B, të cilat kanë një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, dt. 10.05.2017. Të dy godinat ofrojnë kushte shumë të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të KUB. Zyrat dhe mjediset e tjera që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjuterat, printera, skanera, etj.) si dhe të gjitha mjediset mbulohen nga rrjeti wireless që ofron Internet për stafin dhe studentët. Në dispozicion të personelit akademik por jo vetëm, është edhe biblioteka e cila mundëson edhe përdorimin e bibliotekës online falas.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që	Gjatë takimit në institucion me Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, si dhe me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, GVJ u informua se institucioni ofron angazhimin e tij për ti dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të



<p>mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>vazhdueshëm. Institucioni mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. Gjithashtu KUB i ofron personelit mundësinë e trajnimeve të ndryshme nëpërmjet DEI dhe Institutit për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB).</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUB alokon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të personelit akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore. Por, sikurse është cilësuar edhe në Standardin III.4, Kriteri 4-5 i këtij raporti, GVJ konstaton <i>që botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta, dhe GVJ rekomandon që institucioni duhet të iniciojë mekanizma nxitës për stafin, në funksion të botimit të artikujve shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademikë.</i></p> <p>Gjithashtu siç është cilësuar edhe në Standardin II.5, Kriteri 3 i këtij raporti, GVJ konstaton që pothuaj gjysma (6 nga 13) e pedagogëve që mbulojnë ngarkesën akademike në këtë program për vitin akademik 2020-2021, nuk janë ende në proces doktorature. Prandaj <i>GVJ sugjeron që institucioni të angazhohet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit për fillimin sa më të shpejt të studimeve të doktoraturës në fushat e tyre përkatëse.</i></p> <p>Evidenca:  Dok. 18. CV e stafit akademik të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 58. Plani Mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës .pdf  Dok. 36.1. Të dhëna të plota të bashkëpunimeve shkencore jashtë KUB-it.pdf  Dok. 48. Informacion për Institutin për Studime dhe Aplikime në Biznes, vendimi i gjykatës për hapjen.pdf  Dok. 48.1 Aplikimi për zgjerimin e fushës së trajnimeve të ISAB.pdf  Dok. 21.1. Të dhëna tabelore mbi cilësinë e stafit mësimdhënës për programin e studimit IB.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni nxit zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies ku fokusi është në implementimin e modelit “Studenti në Qendër”. Gjithashtu një fokus i veçantë ju dha trajnimit të personelit akademik për mësimdhënien online, nga Grupi i Suportit Teknik të KUB, gjatë vitit akademik 2019 – 2020 dhe 2020 – 2021. Këto trajnime janë përcaktuar në Planin e Veprimit të miratuar nga Senati Akademik sipas Guidës / Udhëzuesit të posaçëm dhe Rregullores së Dedikuar për Procesin Mësimor në Situata të Jashtëzakonshme.</p> <p>Evidenca:</p>

	Dok. 86. Plani i aktiviteteve për zhvillimin e veprimtarive në përbushje të rezultateve të pyetesorit të studentëve dhe personelit akademik në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe në informacionet e marra gjatë vizitës, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës, si njësi kryesore dhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të këtij programi, duke përbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM 418, Maj 2017) dhe nivelin e kualifikimit të stafit (kualifikim i ciklit pasardhës dhe fusha kërkimore e përgjithshme dhe specifike).</p> <p>Gjatë vitit 2020 – 2021 për realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë angazhuar 13 pedagogë si PAE dhe 11 pedagogë me kontratë (PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 6 pedagogë me gradën Dr;</li> <li>- 1 pedagog në proces doktrature;</li> <li>- 5 pedagogë me kualifikimin MSc.;</li> <li>- 1 pedagog me kualifikimin MP.</li> </ul> <p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik përcaktohet me Vendim të Senatit Akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 59, pika 8. Angazhimi i personelit përcaktohet në kontratën e punës dispozitat e së cilës bazohen në Statutin e KUB dhe Rregulloren e KUB.</p> <p>Evidenca:  Dok. 58. Plani Mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës .pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 18.1. Kontratë pune, me kohë të plotë.pdf  Dok. 18.2. Kontratë pune, me kohë të pjesshme.pdf</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë	Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mjediset e Kolegjit Universitar “I Biznesit” dhe konstatoi, bazuar edhe tek dokumentacioni mbështetës, se KUB e zhvillon veprimtarinë mësimore në dy godina A dhe B, që ofrojnë një infrastrukturë

<p>mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, dt. 10.05.2017.</p> <p>Më konkretisht në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në Godinën A 11 janë salla leksionesh, 6 salla seminaresh dhe 1 laborator informatike me 26 PC, për zhvillimin e lëndëve aplikative.</li> <li>- Në Godinën B janë 10 salla leksionesh, 5 salla seminaresh dhe 1 laborator me 24 PC, për zhvillimin e lëndëve si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj.</li> </ul> <p>Evidenca:  Dok. 49. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, ndryshuar.pdf  Dok. 35. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (salla, laboratorë, studio, atelie, hapësirat ndihmëse).pdf  Dok. 35.2. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit, raport i ekspertit për infrastrukturën e KUB.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mbështetur tek vizita në mjediset e institucionit dhe dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se klasat janë të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless falas për studentë dhe stafin dhe tabela inteligjente që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit. Në funksion të zhvillimit sa më mirë të mësimin online KUB ka rritur cilësinë e shërbimit të linjës së Internetit me një shpejtësi 100 Mbps dhe ka përmirësuar infrastrukturën e teknologjisë nëpër klasa. Gjithashtu vlen të përmendet pajisja e sallës Aula Magna me një smartboard, në mbështetje të procesit mësimor online.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe më lart, në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi janë në dispozicion dy laboratorë të teknologjisë së informacionit me 26 dhe 24 PC. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Mund të përmendim programet aplikative të tilla si: Paketa Microsoft Office, DevC++, SQL Server Management Studia, Visual Studio, Arduino, Cisco Pascat Tracer, MySQL Workbench 8.0 CE, Oracle VM VirtualBox, etj. gjithashtu KUB ofron edhe mjedise mësimore të Studios së Shërbimeve të Kontabilitetit, Raportimit Financiar dhe Auditimit, të pajisura me programet aplikative Financa 5, Alpha, Bilanc Standard, të cilat janë në funksion të moduleve të këtij programi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	



	<p>Gjithashtu, laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore janë të pajisura edhe me mjete të tjera të teknologjisë si dhe rrjet Interneti wireless, të cilat janë përmendur në detaje më parë në këtë raport.</p> <p>Të gjitha këto janë në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 35. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (salla, laboratorë, studio, atelie, hapësirat ndihmëse).pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës si dhe bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ u informua se KUB ka nënshkruar 74 marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe institucione të sektorit publik dhe privat, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Ndër to mund të përmendim kompani të njohura në treg të fushës së Informatikës dhe Teknologjisë së Informacionit e Programimit të tilla si: IMB, Bilanc shpk., Infosoft Software Developer, Infosoft System shpk, Info Business Solution, Datech shpk, Ditak shpk, shoqatat IEKA, SHKM, KKK, etj.</p> <p>Gjatë takimit dhe intervistave me studentët GVJ u informua se përveç mundësisë që institucioni i jepte studentëve për të zgjedhur midis kompanive të listës së bashkëpunimit, atyre i ofrohet mundësia ta zgjedhin vetë institucionin ku do të zhvillojnë praktikën mësimore dhe KUB lidh marrëveshje bashkëpunimi me të përpara fillimit të praktikës së studentit.</p> <p>Mbështetur tek sa u tha më sipër, GVJ konstaton se institucioni i ofron studentëve të gjitha mundësitë për të realizuar praktika profesionale të një niveli shumë të mirë.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.pdf</p> <p>Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf</p> <p>Dok. 46. Udhëzues për Praktikën Profesionale.pdf</p> <p>Dok. 46.1. Programi i praktikës profesionale të Programit Informatikë Biznesi.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi Bibliotekën e KUB, të vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka është e organizuar në dy salla, nga një sallë për secilën Godinë A dhe B të institucionit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstaton se biblioteka ka një kapacitet prej 80 vendesh, sipërfaqe prej 65 - 70 m<sup>2</sup> dhe të dyja disponojnë një koleksion fizik prej 6500 librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, të cilët janë në funksion të programeve të studimit që ofrohen në KUB, kryesisht të fushës së drejtësisë dhe ekonomisë. Fondi i librave në Bibliotekë administrohet në mënyrë elektronike dhe në skedarë fizikë. Gjithashtu institucioni ofron mundësinë e aksesit falas në disa biblioteka online në të cilat është abonuar.</p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve.</p> <p>Evidenca:  Dok. 35.1. Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (platformat online - struktura e teknologjisë së informacionit, Biblioteka - Biblioteka online).pdf  Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf  Dok. 71. Rregullore mbi funksionimin e bibliotekës në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Siç e përmendëm dhe më lart biblioteka ka një fond të pasur literature fizike dhe elektronike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, kryesisht të fushës së drejtësisë dhe ekonomisë. <i>Megjithatë siç është cilësuar edhe në Standardin III, Kriteri 5, GVJ konstaton që biblioteka ka një literaturë të kufizuar të botimeve në gjuhën shqipe lidhur me fushën e studimit të Informatikës së Biznesit. Kjo gjë evidentohet edhe në Syllabuset e lëndëve të cilat në disa raste ofrojnë Cikël Leksionesh. GVJ sugjeron që institucioni duhet të pasurojë më shumë Bibliotekën me tekste mësimore bazë të përditësuara, në funksion të programit të studimit të Informatikës së Biznesit.</i></p> <p>Evidenca:  Dok. 17. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf  Dok. 38. Lista e teksteve - periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.pdf  Dok. 35.4. Tituj në Bibliotekën e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “i Biznesit” i ka dhënë mundësi të barabarta dhe pa pagesë studentëve dhe pedagogëve të aksesojnë edhe bibliotekën elektronike që ofrohet nëpërmjet linkut <a href="http://kub.edu.al/biblioteka-elektronike/">http://kub.edu.al/biblioteka-elektronike/</a>. Nëpërmjet kësaj faqeje çdo pedagogu dhe studenti i mundësohet kërkimi në disa biblioteka të huaja online në të cilat KUB është abonuar, të tilla si <a href="https://www.questia.com/">https://www.questia.com/</a> dhe <a href="https://www.academia.edu/">https://www.academia.edu/</a>. Gjithashtu KUB ofron në faqen e vet të</p>

	<p>bibliotekës elektronike edhe akses të lirë për studentët dhe pedagogët në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="http://www.thefreelibrary.com/">http://www.thefreelibrary.com/</a></li> <li>• <a href="https://www.ebsco.com/public-libraries">https://www.ebsco.com/public-libraries</a></li> <li>• <a href="https://www.gutenberg.org/">https://www.gutenberg.org/</a></li> <li>• <a href="https://al.cobiss.net/">https://al.cobiss.net/</a></li> <li>• <a href="http://www.readprint.com/">http://www.readprint.com/</a></li> <li>• <a href="https://about.proquest.com/en/products-services/ebooks-main/">https://about.proquest.com/en/products-services/ebooks-main/</a></li> </ul> <p>Gjithashtu KUB i drejton studentët dhe pedagogët në burime të tjera të literaturës në Internet, të tilla si libra elektronike, revista shkencore, etj, nëpërmjet linkut <a href="http://kub.edu.al/e-resources/?lang=en">http://kub.edu.al/e-resources/?lang=en</a>. Të gjitha këto burime janë vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve pa pagesë.</p> <p>Evidenca: Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Sallat e Bibliotekës së KUB janë të pajisura me katër kompjutera të cilët ju lejojnë studentëve dhe stafit lundrimin falas në Internet dhe në bibliotekat online që mundëson institucioni. Gjithashtu në mjediset e Bibliotekës ofrohet pa kufizim akses në Internet nëpërmjet rrjetit wireless. GVJ konstatoi se hapësirat e bibliotekës janë të përshtatshme për përdorim nga studentët por numri i pajisjeve kompjuterike në to është i vogël. Gjatë bisedës me drejtuesit dhe stafin GVJ u informua se studentët mund të përdorin Laboratorët e Informatikës për nevoja të kërkimit në Internet përveç kompjuterave të Bibliotekës. <i>Megjithatë GVJ sugjeron shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik, për ti dhënë atyre më shumë mundësi të aksesojnë burimet e Internetit në Bibliotekë në të njëjtën kohë.</i></p> <p>Përsa i përket administrimit të fondit të librave të bibliotekës dhe menaxhimit të dokumentacionit të saj, KUB ka blerë vitin e fundit një Softwar Aplikativ e të ri, i cili administron shumë më mirë bazën e të dhënave të Bibliotekës dhe shërbimin me frekuentuesit e saj.</p> <p>Evidenca: Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf <a href="http://kub.edu.al/biblioteka/">http://kub.edu.al/biblioteka/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe të RVB, GVJ konstaton se sipas Planit të Buxhetit Vjetor të KUB, institucioni parashikon rreth 200000 lek për blerjen dhe shtimin e fondit të librave në gjuhën shqipe dhe të huaj. Gjithashtu një pasurim i përvitshëm i bibliotekës vjen nga: botimi i artikujve shkencorë të Konferencave Shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të KUB në Proceedings; Revistat Shkencore të Studimeve Profesionale të KUB; botimet e ardhura nga institucione me të cilat KUB bashkëpunon; etj. Fondi i Bibliotekës pasurohet edhe nga dhurimet, p.sh. ato që vijnë nga</p>

	<p>marëveshja me “New Era Publication International” nga Danimarka, etj.</p> <p><i>Megjithatë duke ju referuar edhe sugjerimit të GVJ në Kriterin 2 të këtij standardi apo edhe në Standardin III, ekspertët janë të mendimit që institucioni duhet të bëjë një koordimim më të mirë të planit vjetor për shtimin e literaturës me nevojat konkrete që kanë lëndët e programit të studimit të Informatikës së Biznesit, sidomos për libra të literaturës bazë të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Evidenca: Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf Dok. 43.1. Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se aktualisht për shkak të kufizimeve të vendosura si pasojë e situatës së Covid-19 dhe mungesës së studentëve në mjediset e KUB, orari i bibliotekës është nga e hëna në të premte në orën 8.30 - 15.00 dhe 16.00 – 19.00.</p> <p>Në kohën kur mësimi zhvillohet në mjediset e KUB orari i bibliotekës është: e hënë – e martë, ora 09.00 – 16.00 dhe e mërkurë – e enjte – e premte ora 09.00 - 20:00. Ky orar shpallet në ambientet e institucionit në hyrje të bibliotekës dhe në faqen e web-it të KUB. Siç u informuam edhe nga studentët këto orare ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe Master.</p> <p>Evidenca: Dok. 35.3. Infrastruktura akademike e Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf <a href="http://kub.edu.al/biblioteka/">http://kub.edu.al/biblioteka/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e KUB, Neni 33) të vënë në dispozicion si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Kolegji Universitar “I Biznesit” e administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim nëpërmjet zyrës së Sekretarisë Mësimore, aktiviteti i të cilës përcaktohet në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Sistemi i sekretarisë administron në rrugë elektronike si dhe në regjistra fizikë të gjitha dokumentat që lidhen me studentët dhe</p>

	<p>aktivitetin e tyre, që nga kontrata, numri i matrikullimit, dokumentat finaciare, regjistrat e notave, regjistrat e amzës, procesverbalet e provimeve, etj.</p> <p>Gjithashtu KUB ka krijuar Portalin e tij, nëpërmjet të cilit menaxhohet komunikimi dhe shpërndarja e materialeve dhe informacioneve që lidhen me procesin mësimor, midis studentëve, personelit akademik dhe Sekretarisë Mësimore. Informacioni mbi rezultatin e provimeve ngarkohet në portal nga sekretaria, pas miratimit të pedagogut përkatës.</p> <p>Evidenca:  Dok. 8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf  Dok. 54. Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom.pdf  Dok. 39. Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Administrimi i dokumentacionit dhe informacionit që lidhet me aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi bëhet nga Zyra e Administratës, Burimeve Njerzore dhe Arkivit. Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e KUB, Neni 36) dhe vizitës që GVJ bëri në këtë zyrë, u informuam që dokumentacioni i plotë ndodhet në dosje fizike, disa prej të cilave u përzgjidhën në mënyrë të rastësishme për tu vëzhguar dhe për njohur me përmbajtje të tyre.</p> <p>Gjithashtu një pjesë e informacionit që lidhet me personelit e KUB është i shfaqur në faqet e web-it të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Në këto faqe gjenden CV-të e pedagogëve dhe informacione të tjera në lidhje me lëndët që zhvillojnë, syllabus-et, prezantimet e leksioneve dhe njoftime. Secili pedagog menaxhon website-in e vet personal, në domain-in e website-t të KUB, nëpërmjet të cilit komunikon me studentët, administratën, etj. I gjithë personeli në KUB është i pajisur me adresë të unifikuar email-i nën domain-in e KUB, që përdoret për komunikimin e brendshëm midis tyre.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së KUB, Kreu IV, përcaktohet organizimi dhe funksionimi i njësisë ndihmëse dhe administrative të KUB, të tilla si Zyra e Mardhënies me Jashtë; Zyra e Mardhënies me Publikun; Sekretaria Mësimore; Zyra e Administratës, Burimeve Njerzore dhe Arkivit; Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar; etj. Këto njësi nëpërmjet informacioneve dhe dokumentave që menaxhojnë sigurojnë akses të dedikuar për të gjithë personelin dhe studentët si dhe përgjegjësit e organeve të tjera drejtuese të KUB. Sipas rastit gjithashtu ato ofrojnë edhe informacione për publikun e interesuar. KUB ofron nëpërmjet një portali të dedikuar informacione për maturantët në lidhje</p>

	<p>me programet e studimit apo edhe institucionet publike apo private, rreth aktivitetit të tij.</p> <p>Evidenca: Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 72. Organigrama e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf <a href="http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-1/">http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-1/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nëpërmjet Portalit <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a> KUB ka integruar platformat Google Classroom dhe Zoom Meet nëpërmjet të cilave zhvillon të gjithë aktivitetin mësimor online dhe komunikimin midis pedagogëve, studentëve, administratës dhe sekretarisë mësimore. Secili pedagog, nëpërmjet një linku personal në Portal për lëndën që zhvillon, mundëson shpërndarjen e të gjithë informacionit që lidhet me aktivitetin mësimor që nga leksionet, seminarët, detyrat e kursit, e deri tek vlerësimi i provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Portali ofron edhe lidhjen nëpërmjet link-eve me shërbime dhe informacione të tjera të tilla si Paketa Udhëzuese të Diplomimi, Paketa Udhëzuese të Praktikës, Bibliotekën elektronike, njoftime, etj.</p> <p>Bazuar tek intervistat gjatë vizitës në institucion, sikurse edhe në dokumentat e dorzuara (Rregullore e Përgjithme e KUB dhe Statuti) secila njësi harton raporte periodike të cilat shërbejnë për informimin e organeve drejtuese të KUB dhe përgatitjen e Raportit Vjetor.</p> <p><i>GVJ konstaton se KUB administron më së miri informacionin dhe dokumentacionin në njësitë përkatëse të të gjitha niveleve në institucion dhe komunikimin apo shkëmbimin e informacionit midis tyre, por sugjeron që ky administrim të bëhet nga një sistem elektronik qendror i menaxhimit të informacionit, ku të gjitha platformat të jenë të integruara në një sistem të vetëm. Në këtë mënyrë sistemi qendror do të mundësojë monitorimin në kohë reale të të gjitha aktiviteteve akademike dhe administrative, si dhe prodhimin më me lehtësi të raporteve sipas kërkesave të organeve drejtuese.</i></p> <p>Evidenca: Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a> <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/lidhje-te-tjera">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/lidhje-te-tjera</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të KUB. Gjithashtu në faqen web-it gjenden informacione të rëndësishme në lidhje me Statutin e KUB, Raportet e Përgjithshme Vjetore, Rregulloret, Planet Strategjike, Raporte të NJSBC, Raporte të Auditit të Jashtëm, etj.</p> <p>Informacionet janë në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht.</p>

	<p>Përveç faqes së web-it, KUB i publikon informacionet e veta të cilat i ndan me publikun edhe në kanale të tjera të informimit dhe media sociale.</p> <p>Evidenca:  <a href="http://kub.edu.al/">http://kub.edu.al/</a>  <a href="http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-1/">http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-1/</a>  <a href="https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view">https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view</a>  <a href="http://kub.edu.al/stafi-akademik/">http://kub.edu.al/stafi-akademik/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit GVJ konstaton se Kolegji Universitar i Biznesit i përcakton në Statutin e vet çështjet që lidhen me buxhetin, financat dhe asetet (Neni 35 – 40). Sipas Statutit (Neni 38), hartimi i buxhetit përgatitet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Senati Akademik pasi është miratuar nga Bordi i Administrimit (Rregullore e KUB Neni 37, Statuti i KUB Neni 40) dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>GVJ u njoh me raportin financiar të institucionit dhe planin për mbështetjen financiare për vitin 2020 – 2021, nëpërmjet dokumentave të dorzuara (Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021). Gjithashtu disa nga treguesit më të rëndësishëm të këtij plani janë pjesë e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë Akademike dhe Financiare” të KUB, të cilat janë të publikura edhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Mbështetur në dokumentat e shlytuara GVJ konstaton se institucioni harton raporte financiare të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Plani i financimit të programit të studimit i përmban të gjitha zërat që përcakton standardi të tilla si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative si dhe zëra të tjerë në përputhje me natyrën specifike të tij. Konstatohet në këtë plan që shpërndarja e detajuar e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucional dhe sipas njësive kryesore dhe bazë, janë bërë duke u mbështetur tek kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/20215, Kreu XI dhe në referencë me parashikimet e Ligjit 9936 datë 26.06.2008.</p> <p>Evidenca:</p>

	<p>Dok. 42. Raporti mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Viti Akademik 2019-2020.pdf  Dok. 43. Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit .pdf  Dok. 43.1. Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  <a href="https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view">https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni kryen auditimin e përvitshëm me Kompaninë Ndërkombëtare të Auditimit “Grant Thornton”, vendimet e të cilës janë të publikuara në faqen zyrtare të web-it të KUB. Gjithashtu në këtë faqe janë publikuar edhe Pasqyrat Financiare Vjetore të çertifikuara. Këto dokumenta depozitohen dhe publikohen edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në dokumentin Relacion për Treguesit Financiarë të Vitit 2020 dhe Parashikimet për Vitin 2021 paraqiten në mënyrë të hollësishme të ardhurat nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Evidenca:  Dok. 43.1. Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf  <a href="https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view">https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view</a>  <a href="https://drive.google.com/file/d/1iaKvyYrGAlmePX36DTWBingjflBfl4b/view">https://drive.google.com/file/d/1iaKvyYrGAlmePX36DTWBingjflBfl4b/view</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se në mbyllje të çdo cikli studimi institucioni dokumenton raportet financiare dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit. Në një mbledhje të përbashkët, çdo vit të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit KUB prezanton dhe analizon Pasqyrat Financiare Vjetore dhe raportin e Audituesit. Mbledhja zhvillohet e hapur dhe në të marrin pjesë edhe përfaqësues të personelit akademik dhe administrativ dhe të studentëve. Këto pasqyra aprovohe nga Senati Akademik pasi janë miratuar nga Bordi i Administrimit (Rregullore e KUB Neni 37, Statuti i KUB Neni 40).</p> <p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi mbështetur në treguesit financiarë të tre viteve të fundit, Zyra e Financës dhe Administratori përgatisin një tabelë të detajuar me të gjithë elementët e shpezimeve dhe planin për vitin në vijim. Në këtë mënyrë institucioni bën vlerësimin e realizimit të programit të studimit, efektivitetin e tij dhe përcakton ndërhyrjet e nevojshme për garantimin e mbarëvajtjes financiare të tij.</p> <p>Evidenca:  Dok. 43.1. Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf</p>



	Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar "I Biznesit".pdf			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se burimi kryesor i të ardhurave të KUB janë tarifaf dhe pagesat e studentëve. burime të tjera janë projektet, trajnimet profesionale që bëhen nëpërmjet ISAB, por edhe nga financimi i vetë investitorëve sa herë që mund të nevojitet.</p> <p>Në bazë të Pasqyrave Financiare Vjetore (link-et më poshtë), dhe dokumentave të dorëzuara në dosjen e vetvlerësimit (dokumenti "Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit") si dhe dokumenti bankar për situatën aktuale financiare të KUB, GVJ konkludon se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view">https://drive.google.com/file/d/1SdrsI4gKEL1ptnDkPNvLYVDY32Z4oIEz/view</a>  <a href="https://drive.google.com/file/d/1iaKvyYrGAlrnePX36DTWBingjLBF14b/view">https://drive.google.com/file/d/1iaKvyYrGAlrnePX36DTWBingjLBF14b/view</a></p> <p>Dok. 42. Raporti mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të Kolegjit Universitar "I Biznesit", Viti Akademik 2019-2020.pdf  Dok. 43. Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit .pdf  Dok. 43.2. Vërtetim Bankar i Kolegjit Universitar të Biznesit.pdf  Dok. 43.1. Relacion për realizimin e treguesve financiarë të vitit 2020 dhe parashikimet për vitin 2021 në Kolegjin Universitar të Biznesit.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Kolegji Universitar “I Biznesit” i ka përcaktuar në Rregulloren e KUB Kreu IX, X dhe në Statut Kreu VI, VII procedurat dhe politikat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me Ligjin Nr. 80/2015, dhe Udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor. Në bazë të këtyre dokumentave GVJ konstaton se se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Njësia Bazë, miratohet nga Njësia Kryesore dhe më pas aprovohen me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të KUB. Më pas këto vendime i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Në bazë të Rregullores së KUB Neni 60, kriteri bazë për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është përfundimi me sukses i ciklit të mesëm dhe nota mesatare që përcaktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Për vitin akademik 2020 – 2021 në bazë të Vendimit të Bordit të Administrimit KUB shpalli si kriter pranimi për ciklin e studimit Bachelor, mesataren mbi 6.5. Kriteret e pranimi dhe informacionet e tjera për procedurat e regjistrimit që duhet të ndjekin kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi janë të publikuara edhe në faqen e webit të KUB.</p> <p>GVJ konstaton se të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në Rregulloren e KUB Neni 79 dhe në Statutin e KUB Neni 72, që përcaktojnë të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga KUB.</p> <p>Evidenca: Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 87. Kuotat e pranimeve për vitin akademik 2021-2022.pdf  Dok. 83. Vendim Bordi i Administrimit për miratimin e ofertës akademike dhe tarifave të studimit V. A. 2020-2021.pdf  <a href="http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a">http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së KUB Neni 60, kriteri bazë për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi është përfundimi me sukses i ciklit të mesëm dhe nota mesatare që përcaktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Për vitin akademik 2020 – 2021 në bazë të Vendimit të Bordit të Administrimit KUB shpalli si kriter pranimi për ciklin e studimit Bachelor, mesataren mbi 6.5. Kriteret e pranimi dhe informacionet e tjera për procedurat e regjistrimit që duhet të ndjekin kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi janë të publikuara edhe në faqen e webit të KUB.</p> <p>GVJ konstaton se të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në Rregulloren e KUB Neni 79 dhe në Statutin e KUB Neni 72, që përcaktojnë të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga KUB.</p> <p>Evidenca: Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 87. Kuotat e pranimeve për vitin akademik 2021-2022.pdf  Dok. 83. Vendim Bordi i Administrimit për miratimin e ofertës akademike dhe tarifave të studimit V. A. 2020-2021.pdf  <a href="http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a">http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimi e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit,</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në kriteret e mësipërme, GVJ konstaton që Rregullorja e KUB përcakton të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimi të studentëve, të përparimit gjatë studimeve, të transferimit, të njohjes së studimeve të mëparëshme, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p>

<p>njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Këto kritere dhe procedura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet faqes së web-it të KUB. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se studentët që në fillim të studimeve marrin në Zyrën e Pranimeve broshurën “Guida Studentore e KUB” e cila përmban informacione të qarta për ta që nga procesi i regjistrimit, rregulloret dhe kriteret e ndryshme në lidhje me gjithë shkollimin e tyre, procedurat e transferimit, kuotat, tarifat e studimit, bursat, aktivitetet dhe këshillat studentore, etj.</p> <p>Të gjitha informacionet e mësipërme publikohet gjithashtu në faqen zyrtare të web-it të KUB dhe rrjetet sociale, në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 57. Guida Studentore.pdf  <a href="https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view">https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view</a>  <a href="http://kub.edu.al/pranimet/#1629374454335-e51a2b55-4ccf">http://kub.edu.al/pranimet/#1629374454335-e51a2b55-4ccf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Ashtu sikurse është cilësuar edhe në Kriterin 1 të këtj Standardi, kriteret për pranimin e studentëve në ciklet e studimit Bachelor në KUB propozohen nga Njësia Bazë, miratohet nga Njësia Kryesore dhe më pas aprovohen me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të KUB. Më pas këto vendime i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e KUB Neni 60) GVJ konstaton se kriteri bazë i pranimit është diploma e shkollës së mesme dhe mesatarja e shkollës së mesme që përcaktohet çdo vit nga MASR. Gjithashtu në këtë nen përcaktohet që institucioni miraton edhe kriteret shtesë për pranimin në ciklin e parë të studimeve dhe ja dërgon ato ministrisë. GVJ nuk konstaton kritere specifike për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Të gjitha informacionet në lidhje me kriteret publikohen në fillim të çdo viti akademik në faqen e web-it të Kolegjit Universitar të Biznesit: <a href="http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a">http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a</a>.</p> <p>Të gjitha kriteret janë hartuar në përputhje me VKM mbi përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve (VKM 295, datë 10.05.2019) si dhe Ligjin Nr. 80/2015, Udhëzimet e MASR dhe vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të KUB. Gjithashtu në bazë të dokumentit “Kuotat e pranimeve për vitin akademik 2021-2022” GVJ konstaton se KUB planifikon në një numër të kufizuar edhe kouta për pranimin e studentë të huaj dhe të trojeve nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, etj. dhe i dërgon ato për miratim në MASR. Ata ndjekin të njëjtën procedurë pranimi dhe regjistrimi të parashikuara në Rregulloren e KUB.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 87. Kuotat e pranimeve për vitin akademik 2021-2022.pdf  <a href="http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a">http://kub.edu.al/pranimet/#1629374458458-29209b78-6b8a</a>.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë vizitës në KUB, se institucioni përdor mjete të ndryshme të informacionit për të njohur publikun e interesuar me programet e studimit që ofron dhe ofertat e tjera akademike dhe financiare. Në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se maturantët të përzgjedhin programet e tyre të studimit, KUB organizon takime informimi me ta. Në bazë të dokumentacionit (Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Neni 6) Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës ka për detyrë të drejtojë dhe menaxhojë rekrutimin e studentëve të rinj. Gjithashtu të angazhuar në këtë process janë edhe Zyra e Mardhënieve me Publikun dhe pedagogët. Mjete të rëndësishme të informimit të kandidatëve për studentë në lidhje me informacione të detajuara për KUB, programet e studimit, kriteret e pranimit, kërkesat për regjistrim, etj, janë Guida Studentore, Fletpalosja e KUB, Broshura e KUB, por edhe informacionet në faqen kryesore të web-it të KUB në të cilën gjendet kurrikulat e programeve, stafi akademik, etj.</p> <p>Gjithashtu KUB përdor edhe mjete të tjera të informimit të publikut të tilla si: reklamat televizive, pjesmarrjet në evente dhe panairë, prezantime të ndryshme, etj.</p> <p>Evidenca:  Dok. 57. Guida Studentore.pdf  Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.pdf  Broshura:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1Kl0tvNw4IO55aWLzXNnQ2jrN2tZA_Eggq/view">https://drive.google.com/file/d/1Kl0tvNw4IO55aWLzXNnQ2jrN2tZA_Eggq/view</a>  Fletpalosja:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1vd3bnHW7ptgX0qz_bS1b-KwlPOsg0bl/view">https://drive.google.com/file/d/1vd3bnHW7ptgX0qz_bS1b-KwlPOsg0bl/view</a>  <a href="http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise/">http://kub.edu.al/fakulteti-i-ekonomise/</a>  Programi:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view">https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstaton që KUB informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Ky informim fillon me Guidën Studentore e cila përmban informacione të hollësishme në lidhje me këto procedura. Gjatë</p>

<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>regjistrimit të tyre studentët marrim informacione të rëndësishme në lidhje me procesin mësimor, oraret, detyrimet akademike, provimet, etj, nëpërmjet sekretarisë mësimore. Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve syllabueset e lëndëve, procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, kërkesat për frekuentimin, etj. Nëpërmjet aksesit që kanë në portalin e KUB studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me sekretarinë mësimore dhe pedagogët dhe informohen vazhdimisht për çdo aktivitet apo detyrim gjatë vitit akademik në lidhje me lëndët dhe kalimin nga njëri vit në tjetrin.</p> <p>Gjithshtu informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në: Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, Kreu II; Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu VI, VII; Rregulloren e KUB, Kreu XI.</p> <p>Evidenca:  Dok. 57. Guida Studentore.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton që KUB i përcakton në Rregulloren e tij Neni 74, 75 procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme për studentët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në KUB dhe procedurat për tranferimet nga KUB drejt IAL të tjera. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohet në “Rregulloren për Ekuivalentimin dhe Transferimin e Studimeve”, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sekretaria Mësimore jep informacionin e plotë për të gjithë studentët e interesuar që duan të bëjnë transferimin, ndërsa vendimi për njohjen e krediteve të mëparshme bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të drejtuesit të njësisë kryesore dhe në përputhje me Rregulloren për Ekuivalentimin dhe Transferimin e Studimeve. Studentët mund të marrin informacionet për transferimin edhe nëpërmjet faqes së web-it të KUB.</p> <p>Evidenca:  Dok. 56. Rregullore per njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve ne KUB.pdf  <a href="https://kub.edu.al/sq/procedurat-per-transferimin-e-studimeve-ne-kub/">https://kub.edu.al/sq/procedurat-per-transferimin-e-studimeve-ne-kub/</a>  <a href="https://kub.edu.al/pranimet/#1629374454335-e51a2b55-4ccf">https://kub.edu.al/pranimet/#1629374454335-e51a2b55-4ccf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara qartë në disa dokumenta të rëndësishme të institucionit, përkatësisht në: Rregulloren për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve Neni 10, 11, 12; Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Neni 11, 12; Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p>

	<p>Neni 30; Rregullore e KUB Neni 93. Të gjithë këto dokumenta janë të aksesueshëm për studentët e KUB.</p> <p>Megjithatë studentët informohen në fillim të çdo semestri në çdo lëndë, për procedurat e vlerësimit të dijeve nga pedagogët e tyre, gjatë prezantimit të lëndës dhe syllabusit përkatës. Gjithashtu Sekretaria Mësimore informon studentët në çdo rast që ata kanë nevojë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4.1. Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ kostaton se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në KUB përcaktohen në Rregulloren e KUB Kreu XIV. Gjithashtu ato janë të specifikuar edhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë Kreu IX, Rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës Kreu IV dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Biznesi Kreu II.</p> <p>Në rregulloret e mësipërme përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbrohet me provim formimi ose temë diplome. Studentët informohen për këtë nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Kriter për përcaktimin e mbrojtjes me temë është mesatarja e notave të studentit deri në semestrin e parafundit përpara diplomimit. Nëse studenti fiton të drejtën e mbrojtjes me temë ai pajiset me “Paketën Udhëzuese për Mbrojtjen e Diplomës me Temë”. Nëse studenti do të mbrojë diplomën me provim formimi ai pajiset me “Paketën Udhëzuese për Mbrojtjen e Diplomës me Provim Formimi”.</p> <p>Njoftimet për procedurat e mbrojtjes së diplomës janë të afishuara edhe në faqen e web-it të KUB, në portalin e sekretarisë, në hollin e institucionit, dhe në media të tjera sociale që përdoren për njoftimin e studentëve.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjithë studentët kishin marrë informacionet e nevojshme për të gjithë procesin e diplomimit të tyre, qoftë ata me provim përfundimtar qoftë ata me temë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 5. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.pdf  Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 5.1. Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.pdf  Dok. 47.3. Paketë udhëzues për mbrojtjen e diplomës me temë.pdf  Dok. 47.2. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me provim formimi.pdf</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sikurse është cilësuar edhe në Standardin V.1 Kriteri 6 i këtij raporti, GVJ konstaton se Kolegji Universitar i Biznesit në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se maturantët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyrës së Mardhënieve me Publikun, pedagogëve, etj. KUB rinovon dhe publikon Guidën Studentore, Fletpalosjen e KUB dhe Broshurën e KUB, nëpërmjet të cilave informon të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për ofertat e veta akademike dhe financiare. Gjithashtu studentët e ardhshëm prezantohen me programin e studimit që do të ndjekin dhe elementët kryesorë që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Evidenca:          Guida Studentore:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view">https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view</a>          Broshura:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1K10tvNw4IO55aWLzXNnQ2jrN2tZAEgqg/view">https://drive.google.com/file/d/1K10tvNw4IO55aWLzXNnQ2jrN2tZAEgqg/view</a>          Fletpalosja:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1vd3bnHW7ptgiX0qz_bS1b-KwlPOsg0bl/view">https://drive.google.com/file/d/1vd3bnHW7ptgiX0qz_bS1b-KwlPOsg0bl/view</a>          Programi:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view">https://drive.google.com/file/d/1d6UCqrdD6WLMK08NDS7vvYtDr4K-XvLA/view</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar i Biznesit ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma Bachelor në “Informatikë Biznesi”. Në bazë të Rregullores së Programit, programi zhvillohet në gjuhën shqipe. Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë dhe 60 kredite. Në fund të çdo semestri ka sezon provimesh, dhe në fund të vitit akademik ka sezonin e vjeshtës. Në varësi të kërkesave dhe me urdhër të Rektorit ofrohen edhe sezone shtesë. Organizimi i provimeve përcatohet në “Rregulloren për Procedurat për Zhvillimin e Provimeve” por jo vetëm. Të gjitha informacionet në lidhje me strukturën e këtij programi studimi, organizimin dhe kohëzgjatjen ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre nëpërmjet Zyrës së Sekretarisë Mësimore, me anë të broshurës “Guida Studentore” por edhe gjatë takimeve para regjistrimit si student nga Zyra e Mardhënieve me Publikun.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	



	<p>GVJ u informua gjishtashtu se informacione të hollësishme studentët marrin edhe në fillimit të çdo semestri nga Sekretaria Mësimore dhe pedagogët për oraret, lëndët që do të zhvillojnë, detyrimet, strukturën e semestrit, provimet, etj. Gjithashtu secili pedagog në prezantimin e lëndës shpjegon syllabusin, i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit dhe materialeve të lëndës, objektivave formuese, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>Çdo informacion në lidhje me këtë program studimi përsa i përket strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së programit, moduleve, lëndëve, përmbajtjes dhe veprimtarive formuese është lehtësisht i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqeve të web-it të KUB dhe portalit të tij që e lidh studentin me pedagogun dhe Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 6. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi.pdf</p> <p>Dok. 4.1. Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve.pdf</p> <p>Guida Studentore:</p> <p><a href="https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view">https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view</a></p> <p>Dok. 57. Guida Studentore.pdf</p> <p><a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a></p> <p>Dok. 14.5. Struktura Mësimore vjetore për Vitin Akademik 2020-2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit GVJ konstaton që KUB i jep studentëve informacione mbi mundësitë e punësimit që në prezantimin e tyre me programin e studimit që ata dëshirojnë të ndjekin, dhe më pas gjatë kohës që ata janë studentë. Nëpërmjet faqes së web-it tek Pranimet studentët informohen për nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar në KUB për periudhën 2012 - 2018, rezultatet të marra nga një sondazh i kryer nga Zyra e Studentit dhe Karrierës. <i>Përsa i përket studimit të tregut në lidhje me nevojën për të diplomuar në Informatikë Biznesi, GVJ rekomandon përmirësimin e metodologjisë së realizimit të studimit dhe shtrirjen e tij në një treg më të gjërë se tregu i brendshëm (evidentuar edhe në Standardin I.3 Kriteri 2).</i></p> <p>Zyra e Studentit dhe Karrierës është gjithë kohën në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës, ju jep studentëve informacione rreth mundësive të ndryshme që institucioni në bashkëpunim me partnerët për trajnimet, aktivitete të ndryshme, internshipe, praktika profesionale dhe mundësitë e punësimit. Kjo zyrë ka një rubrikë të dedikuar në web si dhe një fanpage në rrjetin social facebook ku shpërndan vazhdimisht informacione për studentët.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi nuk ka tregues të matur në lidhje me punësimin e studentëve, sepse këtë vit akademik diplomohet brezi i parë. Megjithatë në takimin me studentët GVJ u informua që tre prej studentëve kishin marrë oferta punësimi nga kompanitë që kishin kryer praktikën mësimore.</p>




	<p>Vetë institucioni përpiqet që nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar të krijojë urën lidhëse midis studentëve që diplomon dhe tregut të punës.</p> <p>Evidenca:  Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.pdf  <a href="https://kub.edu.al/pranimet/#1629374459864-625214c9-8200">https://kub.edu.al/pranimet/#1629374459864-625214c9-8200</a>  Dok. 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.pdf  Dok. 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe Brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët njihen që në fillim të studimeve të tyre në KUB me mënyrën e organizimit të procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën në funksion të këtij procesi, shërbimet që ofron institucioni për ta, nëpërmjet informacioneve të marra në Zyrën e Pranimeve, Zyrën e Sekretarisë Mësimore, Guidës Studentore dhe nga faqja e web-it të KUB. Në hollën e institucionit shpallet orari i mësimit, si dhe njoftime të ndryshme në lidhje me aktivitete të ndryshme, trajnime, workshop-e, etj. Studentët njihen që në fillim me mjediset e institucionit në shërbim të procesit mësimor por jo vetëm, të tilla si sallat e mësimit, bibliotekën, librarinë, etj. Këto informacionet gjenden edhe në faqen e web-it.</p> <p>Evidenca:  Guida Studentore:  <a href="https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view">https://drive.google.com/file/d/1qGZZRswjsf4yT6bR7x3fWvup64k-udsG/view</a>  <a href="https://kub.edu.al">https://kub.edu.al</a></p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Informacionet në lidhje me programin e studimit studentët e marrin nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me pedagogët, Sekretarinë Mësimore, apo edhe nëpërmjet faqes së web-it të KUB, Portalit të Studentit, etj. Të gjitha burimet janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët edhe në distance, sidomos nëpërmjet Portalit ata marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me mësimin.</p> <p>Evidenca:  <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Sekretarisë Mësimore, GVJ u informua që kjo zyrë është përgjegjëse për mbajtjen e statistikave vjetore për</p>

<p>studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>numrin e studentëve në secilin program studimi, dhe numrin e të diplomuarve përkatës. Këto statistika mblidhen dhe përpunohen në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Udhëzimit të MAS “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore“, Udhëzimit të MAS, Nr. 16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve“, si dhe udhëzime të tjera që dalin çdo vit.</p> <p>Gjithashtu Sekretaria Mësimore mban për çdo program studimi të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Kjo zyrë disponon regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike (të notave), regjistrin e pedagogëve, regjistrin e lëshimit të diplomave, raportet e praktikave, etj. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në dokumenta fizikë (hard copy) dhe elektronike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion përfaqësues të Zyrës së Sekretarisë në vënë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi. Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, ky është një program i hapur në vitin akademik 2018 – 2019 dhe këtë vit akademik diplomohen studentët e brezit të parë. Bazuar në dokumentin: “Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, transferimi i studimeve” tabelat e mëposhtme paraqesin për tre vitet e fundit akademike përkatësisht:</p> <p>Tabela 1: Numri i të regjistruarve dhe mesatarja përkatëse</p> <table border="1" data-bbox="730 1055 1342 1350"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të regjistruar në vit të parë</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>15</td> <td>7.63</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>16</td> <td>7.59</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>7</td> <td>7.54</td> </tr> </tbody> </table> <p>Tabela 2: Numri i të diplomuarve dhe mesatarja përkatëse</p> <table border="1" data-bbox="718 1456 1353 1603"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Numri i studentëve të diplomuar</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021*</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>*Ky raport është hartuar përpara diplomimit të studentëve të brezit të parë në KUB</p> <p>Tabela 3: Numri i studentëve të transferuar dhe atyre të larguar</p> <table border="1" data-bbox="703 1749 1370 1892"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të transferuar</th> <th>Studentë të larguar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	2018-2019	15	7.63	2019-2020	16	7.59	2020-2021	7	7.54	Viti akademik	Numri i studentëve të diplomuar	Nota mesatare	2020-2021*	-	-	Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar	2018-2019	3	-
Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje																							
2018-2019	15	7.63																							
2019-2020	16	7.59																							
2020-2021	7	7.54																							
Viti akademik	Numri i studentëve të diplomuar	Nota mesatare																							
2020-2021*	-	-																							
Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar																							
2018-2019	3	-																							
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>																									
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>																									

	<table border="1" data-bbox="710 91 1382 203"> <tr> <td>2019-2020</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> </table> <p>Gjithashtu në Sekretarinë Mësimore mbahet dokumentacioni që tregon rezultatet (rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare) e studentëve gjatë gjithë ecurisë së programit të studimit. Rezultatet regjistrohen në procesverbalet sipas lëndëve në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 Neni 101. Më pas notat hidhen në regjistrin e notave.</p> <p>Evidenca:  Dok. 23. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, transferimi i studimeve.pdf  Dok. 8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</p>	2019-2020	2	-	2020-2021	2	-
2019-2020	2	-					
2020-2021	2	-					
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësuese të Zyrës së Sekretarisë Mësimore, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjisin e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës, GVJ u informua që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në mënyrë të sigurtë dhe sipas rastit janë lehtësisht të aksesueshme për këdo që është i autorizuar (studentët, pedagogët, drejtuesit e institucionit, etj). Të dhënat rruhen në regjistra fizike dhe format elektronik. Aksesin në informacion studentët dhe pedagogët e marrin nëpërmjet Portalit të KUB si edhe në mënyrë të dretjepërdrejtë në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Megjithatë ashtu sikurse e kemi cilësuar në Standardin IV.5 Kriteri 5 i këtij raporti, GVJ sugjeron përdorimin e një sistemi qendror të integruar të menaxhimit të të dhënave të institucionit në formën e një LMS, për një komunikim më efektiv dhe siguri më të madhe.</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, GVJ konstaton se KUB harton raporte analitike për cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje. Këto raporte janë në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në shërbim të njëjësive dhe drejtuesve të institucionit për të realizuar analizat vjetore.</p> <p>Këto raporte gjenden në dokumentat: “Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, transferimi i studimeve”; “Raporti mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Viti Akademik 2019-2020”; “Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional”.</p> <p>Përsa i përket nivelit të punësimit të studentëve të diplomuar në programet e ndryshme të studimit, është Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ajo që merret me mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar, realizimin e anketave për studentët e punësuar</p>						




	<p>dhe hartimin e raporteve për nivelin e punësimit. Të dhënat gjenden në dokumentin “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB”. <i>Ky raport përmban kryesisht të dhëna përshkruese për përqindjen e punësimit të studentëve në profesion ose jo, të vetpunësimit, ose përqindjen e atyre që nuk janë punësuar ende, por nuk paraqitet ndonjë tregues ose analizë për shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe masat që duhen marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. GVJ sugjeron zgjerimin e treguesve të marrë prej pyetsorit dhe një analizë më të detajuar të të dhënave të përfituara prej tij.</i></p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, akoma nuk ka tregues të nivelit të punësimit të studentëve meqënëse këtë vit akademik diplomohet brezi i parë.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok. 42. Raporti mbi veprimtarinë akademike dhe financiare të Kolegjit Universitar “I Biznesit”, Viti Akademik 2019-2020.pdf</p> <p>Dok. 81. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB.pdf</p> <p>Dok. 31. Analizë periodike e Fakultetit të Ekonomisë Viti Akademik 2020-2021, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.pdf</p> <p>Dok. 23. Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, transferimi i studimeve.pdf</p> <p>Dok. 16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit Informatikë Biznesi.pdf</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	GVJ konstaton se KUB parashikon përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 98, 99. Në bazë të Statutit të KUB Neni 17, 23, 73, 82 si dhe të Rregullores së KUB, Neni 9, 15, 80, 113 studentët kanë të drejtë të zgjidhen në:
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Senatën Akademik – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor</li> <li>- Këshillin e Etikës – 1 anëtar</li> <li>- Këshillat studentorë – sipas njësive kryesore</li> </ul>

<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>- Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – 1 anëtar i zgjedhur nga këshilli studentor</p> <p>Këshilli studentor është organi më i rëndësishëm i studentëve cili përfaqëson dhe mbron interesat studentore. Ai zgjidhet çdo dy vjet në mënyrë demokratike nga vetë studentët si dhe me mbikëqyrjen e një grupi të posaçëm pedagogësh. Gjatë mandatit aktual ai përbëhet nga 13 anëtarë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët GVJ u informua se nevojat dhe shqetësimet e tyre janë adresuar vazhdimisht në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit. Kjo gjë na u pohua edhe në takimin me Koordinatorin e Programit dhe Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës. Konkretisht GVJ u informua që studentët kanë adresuar shqetësimet në lidhje me procesin e mësimit online të cilat u zgjidhën nëpërmjet komunikimit të përfaqësuesve të tyre me drejtuesit.</p> <p>Evidenca: Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf <a href="https://kub.edu.al/keshilli-studentor/">https://kub.edu.al/keshilli-studentor/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Kolegji Universitar i Biznesit ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Informatikë Biznesi me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS). Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë dhe 30 kredite secili. Kreditet minimale evropiane për një lëndë janë 5 ECTS dhe maksimumi 7 ECTS. GVJ konstaton se gjatë hartimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi, ngarkesa e mësipërme akademike është marrë në konsideratë, si dhe hartimi i programit është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe udhëzimet e MASR.</p> <p>Gjithashtu procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve apo dhe njohjet e studimeve të mëparshme bëhen në përputhje me Rregulloren e KUB, Neni 93-100, Neni 74-75. GVJ konstaton që këto procedura janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p> <p>Evidenca: Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf Dok. 56. Rregullore për njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve në KUB.pdf <a href="https://kub.edu.al/sq/procedurat-per-transferimin-e-studimeve-ne-kub/">https://kub.edu.al/sq/procedurat-per-transferimin-e-studimeve-ne-kub/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstatoi se kërkesat dhe shqetësimet e studentëve përsa i përket përmirësimit të procesit mësimor, syllabuseve, literaturës, mënyrës së mësimdhënies, vlerësimit, etj, merren në konsideratë nga institucioni dhe diskutohen në organet drejtuese. Kryesisht këto adresime vijnë nëpërmjet përfaqësuesve të Këshillit Studentor në Senatit Akademik apo në komisionet e tjera të përherëshme ku ata kanë përfaqësi.</p>

	<p>Nëpërmjet pyetsorëve që janë realizuar nga NJSBC e KUB, por edhe nga IQE (Instituti për Cilësi në Arsim) studentët janë pyetur për aspekte të ndryshme të cilësisë së programit të studimit, ku ka pasur edhe pyetje të hapura ku studentët mund të shprehnin mendimin e tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit që ndjekin. <i>Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument apo analizë për rishikim të programit të studimit në bazë të ndonjë propozimi nga studentët apo rezultatet që paraqesin Raportet e Pyetsorëve.</i> Gjithsesi në takimin me studentët dhe pedagogët GVJ u informua se pedagogët janë gjithmonë në komunikim me studentët për çdo kërkesë apo problematikë që atë mund të paraqesin, në shërbim të përmirësimit të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca:  Dok. 78.3. Raportet e Pyetësorit të studentëve IQE.pdf  Dok. 30.5. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf  Dok. 78. Tip pyetësor studenti nga IQE.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe takimit me studentët, GVJ konstaton se studentëve ju jepet mundësia të vlerësojnë performancën e pedagogëve në të gjitha aspektet e procesit mësimor, që nga procesi i mësimdhënies deri tek vlerësimi. Në bazë të Rregullores për Procedurat e Zhvillimit të Provimeve, Neni 16, studentëve ju jepet e drejta të ankimojnë rezultatin e marrë të provimit, me një kërkesë me shkrim në Sekretarinë Mësimore jo më vonë se 3 ditë nga shpallja e rezultateve. GVJ u informua nga studentët se ka pasur raste të ankimit të rezultateve nga ata, të cilat janë shqyrtuar me korrektësi nga pedagogët përkatës, në përputhje me rregulloren e mësipërme.</p> <p>Evidenca:  Dok. 4.1. Rregullore për procedurat e zhvillimit të provimeve.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, por edhe të dokumentacionit të shqyrtuar (Guida Studentore, Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës) GVJ konstaton se KUB ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit ndaj studentëve. Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës janë dy zyra që asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacion e këshillim për çështje të lidhura me procesin akademik dhe përfshirjen e studentëve në tregun</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin,</p>	




<p>këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>e punës, përzgjedhjen e karrierës dhe vendin ku do të kryejnë praktikën, etj.</p> <p>Gjithashtu informimi i studentëve bëhet nëpërmjet këndit të njoftimeve në hollin e institucionit, njoftimeve në faqen e web-it, mediave sociale, etj. Sistemi i informimit online në KUB gjithashtu mbështetet edhe nga Portali i Sekretarisë Mësimore dhe komunikimi në Google Classroom dhe Google Meet.</p> <p>Evidenca: Dok. 8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.pdf Dok. 57. Guida Studentore.pdf <a href="https://kub.edu.al/lajme-vente/">https://kub.edu.al/lajme-vente/</a></p>
---	---

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sikurse u cilësua edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Në bazë të Rregullores së kësaj zyre ajo ka si mision dhe qëllim (Neni 4-5) të jetë sa më afër studentëve duke i mbështetur në këshillim, konsultim, duke ju ofruar informacioni për trajnime, intershipe, praktika profesionale, punësim, etj. Kjo zyrë (Neni 6) është përgjegjëse për procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban mardhënie me këshillat studentorë, drejton këshillimin e studentëve, mban komunikim me tregun e punës, ofron asistencë në orientimin e karrierës profesionale të studentëve.</p> <p>Evidenca: Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.pdf</p>
---	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Neni 6, kjo zyrë ka si detyrë të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit dhe të përgatisë Librin e Karrierës. GVJ konstaton se kjo zyrë merret me mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar, realizimin e anketave për studentët e punësuar dhe hartimin e raporteve për nivelin e punësimit. Të dhënat gjenden në dokumentin “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB”. Ky raport përmban kryesisht të dhëna përshkruese për përqindjen e punësimit të studentëve në profesion ose jo, të vetpunësimit, ose përqindjen e atyre që nuk janë punësuar ende. Këto të dhëna janë vënë në dispozicion të studentëve dhe autoriteteve drejtuese nëpërmjet raportit të sipërpërmendur. Gjithashtu gjenden të publikuara edhe në faqen e web-it të institucionit.</p> <p>Evidenca: Dok. 81. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB.pdf</p>
---	---


<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “I Biznesit” ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Kodin e Cilësisë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe aktet rregullatore institucionale. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është struktura kryesore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo njësi është ngritur në vitin 2012, me vendim të Bordit Drejtues të Akademisë Profesionale të Biznesit (sot KUB). NJSBC funksionon në bazë të Statutit të KUB (Kreu IX, Neni 81, 82), Rregullores së KUB (Kreu XVI, Neni 112, 113) dhe Rregullores së Njesisë së Brendëshme të Cilësisë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 2. Statuti i Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 4. Rregullore e Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf  Dok. 7. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton që KUB nëpërmjet NJSBC zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional. NJSBC ka për qëllim monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetsorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj. Në bazë të Rregullores së NJSBC kjo njësi është e përbërë nga pesë anëtarë, tre janë përfaqësues të stafit akademik të tre Njësive Kryesore të KUB, një është përfaqësues i Këshillit të Studentëve, dhe një është ekspert i jashtëm. Faktikisht kjo njësi ka 7 anëtarë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 7. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf  <a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Aspektet kryesore në të cilat NJSBC e ka përqëndruar punën për sigurimin e cilësisë janë monitorimi i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, analiza e programeve të studimit (kurrikulave) si dhe analiza e programeve të lëndëve (syllabus-eve). NJSBC është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe pedagogëve, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetsorët, përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për porcesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj. GVJ konstaton që sistemi për sigurimin e cilësisë në KUB përdor instrumenta të ndryshëm që ndjekin një politikë të qartë dhe të bazuar mbi një plan pune për çdo vit akademik.</p> <p>Gjithashtu institucioni i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm me qëllim akreditimin institucional dhe të programeve të</p>






	<p>studimit. Akreditimi institucional i IAL “Kolegji Universitar i Biznesit” është bërë me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr. 557 datë 16.11.2012, “Për akreditimin institucional të Kolegjit Universitar të Biznesit”, gjithashtu është ri akredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afat vlefshmërie 10.11.2021 dhe aktualisht është në proces të riakreditimit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Biznesi” është licensuar bazuar në Urdhrin Nr. 392, datë 10.07.2018. Ky program është në process akreditimi për here të parë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 30. Plani i Punës së NjsBC për Vitin Akademik 2020-2021.pdf  Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjsBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf  Dok. 30.2. Raport mbi kontrollin e syllabusit për modulin.pdf  Dok. 30.3. Raport mbi kontrollin për procesin mësimor online.pdf  Dok. 30.4. Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf  Dok. 33. Pyetësori i studentëve.pdf  Dok. 34. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf  Dok. 12.5. Urdhri i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për hapjen e programit të studimit IB.pdf  Dok. 68. Vendimin Nr. 100, datë 10.11.2017 të BA, Për akreditimin institucional të Kolegjit Universitar “I Biznesit”.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB ka hartuar politika dhe procedura periodike në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, që synojnë përmirësimin e programeve të studimit që ofron. NJSBC gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm realizon mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve, bën kontrolle periodike për syllabus-et e lëndëve, procesverbalet, tezat, fletët e provimit, etj. Në fund vitit akademik NJSBC përgatit një raport vjetor në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Roli i NJSBC është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimitarisë akademike dhe kërkimore në KUB.</p> <p>Evidenca:  Dok. 30. Plani i Punës së NjsBC për Vitin Akademik 2020-2021.pdf  Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjsBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nak përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni ka ngritur njësi të posaçme për monitorimin dhe rishikim e programeve të studimit. Në bazë të Nenit 4 të Rregullores së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, kjo njësi është përgjegjëse për vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Ky vlerësim kryhet në mënyrë periodike. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek Rektori.</p> <p>Evidenca: Dok. 7. Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf <a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se mekanizmat që përdor NJSBC për mbikëqyrjen e programeve të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formulari për vlerësimin e performancës së stafit</li> <li>- Pyetsori i stafit akademik dhe ndihmës akademik</li> <li>- Pyetsori i studentit</li> <li>- Formulari për vlerësimin e syllabusit</li> <li>- Formulari për kontrollin e procesit mësimor online</li> <li>- Formulari për kontrollin e provimit online</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga sa më sipër konkludojmë që institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve. Këto mekanizma janë të publikuar edhe në faqen e web-it të KUB.</p> <p>NJSBC i përdor këto mekanizma periodikisht në fund të çdo semestri dhe viti akademik dhe rezultatet e nxjera nga përpunimi i pyetsorëve apo formularëve të tjerë i paraqet në Raportin Përmbledhës të NJSBC. <i>Megjithatë GVJ nuk konstaton në këtë raport, se cila është metodologjia e përdorur për vlerësimin e elementëve përbërës të pyetsorëve dhe çfarë peshe zënë pyetjet në vlerësimin tërësor të procesit mësimor.</i></p> <p>Gjithashtu në bashkëpunim me IQE (Institutin për Cilësi në Arsim) NJSBC ka realizuar gjatë majit 2021 një anketim për pedagogët dhe studentët për të vlerësuar procesin mësimor në KUB. <i>Edhe në këtë rast nuk evidentohet ndonjë metodologji e përdorur për vlerësimin e elementëve përbërës të pyetsorëve.</i></p> <p><i>Në të dy raportet të dhënat e marra nga çdo pyetje janë paraqitur në një analizë deskriptive. Për sa më sipër GVJ rekomandon përdorimin e një metodologjie të qartë në realizimin e anketave dhe përpunimin e tyre, duke i dhënë peshën e duhur secilës gjetje në raportin përfundimtar.</i></p> <p>Evidenca: Dok. 77. Format i Vlerësimit të performancës së Stafit të KUB.pdf Dok. 34. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf Dok. 33. Pyetësori i studentëve.pdf</p>



	<p>Dok. 30.2. Raport mbi kontrollin e syllabusit për modulin.pdf  Dok. 30.3. Raport mbi kontrollin për procesin mësimor online.pdf  Dok. 30.4. Raport mbi kontrollin provimeve online.pdf  Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjsBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf  <a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51</a>  Dok. 78. Tip pyetësor studenti nga IQE.pdf  Dok. 78.1 Tip pyetësor stafi akademik nga IQE.pdf  Dok. 78.2. Raportet e Pyetësorit të stafit IQE.pdf  Dok. 78.3. Raportet e Pyetësorit të studentëve IQE.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve që bën NJSBC por edhe rezultatet e vlerësimit nga ekspertë të jashtëm (IQE , Institutin për Cilësi në Arsim) të kontaktuar nga institucioni ju vihen në bëhen të njohura njëjësive bazë, njëjësive kryesore, si dhe drejtuesve të këtyre njëjësive. Gjithashtu në bazë të Rregullores, NJSBC raporton drejtpërdrejt tek Rektori.</p> <p>Gjithashtu këto rezultate janë të publikuara edhe në faqen e web-it të KUB.</p> <p>Evidenca:  Dok. 30.1. Raport përmbledhës NjsBC për procesin mësimor sem I dhe II KUB viti akademik 2019-2020.pdf  Dok. 78.2. Raportet e Pyetësorit të stafit IQE.pdf  Dok. 78.3. Raportet e Pyetësorit të studentëve IQE.pdf  <a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464526-5829fdf6-5e51</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një plan masash për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe elementëve të tjerë të programeve të studimit, duke u mbështetur tek raportet e vlerësimit të NJSBC dhe IQE. <i>Në këtë plan masash (Dok. 86) nuk gjejmë ndonjë analizë për të kuptuar problematikat e evidentuara. GVJ sugjeron që NJSBC duhet të diskutojë gjetjet e raporteve me njësitë bazë në mënyrë që plani i aktiviteteve të sugjeruara prej saj të jetë sa më efektiv në adresimin e problematikave të evidentuara.</i></p> <p>Evidenca:  Dok. 86. Plani i aktiviteteve për zhvillimin e veprimtarive në përbushje të rezultateve të pyetësorit të studentëve dhe personelit akademik në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	


### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Ashtu sikurse është cilësuar edhe në standardin VI.1, 2 të këtij raporti, GVJ konstaton se institucioni kryen në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC vlerësimin e brendshëm të programit të studimit. Ky vlerësim kryhet për çdo semestër gjatë vitit akademik. NJSBC është e angazhuar në anketimin e studentëve dhe pedagogëve, hartimin e raporteve të të dhënave të marra nga pyetsorët, përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, etj. Këto raporte janë pjesë e RVB edhe për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Biznesi, që po trajtohet në këtë Raport të Vlerësimit të Jashtëm.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p>Raporti i Vlersimit te Brendshem-Programi i Studimit i Ciklit të Parë Bachelor ne Informatikë Biznesi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe më parë në këtë raport (Standardi VI.2) institucioni përdor instrumente të posaçme dhe të përshtatshme për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi të tilla si: pyetsorët për pedagogët dhe studentët; formularë për kontrollin e provimeve, mësimin online, syllabuseve, etj.</p> <p>Sipas RVB, institucioni i ka dhënë një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me biznesin dhe përfshirjes së partnerëve në procesin e përmirësimit të këtij programi studimi për ta sjellë atë në përputhje me nevojat e tregut. Në këtë kuadër mund të përmendim bashkëpunimin me Qendrën Kërkimore „Tirana Business Research Center“.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Përveç metodave të sipërpërmendura, NJSBC kryen vlerësim të mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit edhe me metoda të drejtpërdrejta. NJSBC realizon kontrole të herëpsherëshme të orëve të mësimin, të hartimit të tezave, të provimeve të korigjura duke zgjedhur kampione për të verifikuar saktësinë e tyre, etj. Gjithashtu në kuadër të përmirësimit të cilësisë institucioni realizon edhe trajnime të stafit akademik, sidomos gjatë kalimit të procesit mësimor online për tu përshtatur sa më mirë stafi akademik me përdorimin e teknologjisë së informacionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në</p>	<p>Ashtu sikurse është cilësuar edhe në standardin VI.1, 2 të këtij raporti, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet NJSBC përdor metoda të tërthorta për kontrollin e cilësisë së këtij programi studimi siç janë: pyetsori me studentë, pyetsori me stafin akademik dhe ndihmës akademik, intervista me stafin administrativ (Rregullore e NJSBC, Neni 4). Gjithashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër në Standardin V.6 të këtij raporti, është detyra e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës të grumbullojë informacione mbi të diplomuarit. Kjo zyrë merret me mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar, realizimin e anketave për studentët e punësuar dhe hartimin e raporteve për</p>



realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	nivele e punësimit. Të dhënat gjenden në dokumentin “Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB”.			
	Evidenca: Dok. 81. Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve në KUB.pdf Dok. 7. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sikurse është cilësuar edhe në Standardin VI.1 të këtij raporti, si dhe bazuar në dokumentat e shqyrtuara (Statuti i KUB dhe Rregulorja e NJSBC në KUB), GVJ konstaton se institucioni ka ngritur struktura dhe ka hartuar procedura për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të veta të studimit. Gjithashtu konstatohet që në këto politika dhe procedura janë të përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm, e përcaktuar kjo që në organizimin e NJSBC sipas Nenit 2 të Rregullores së NJSBC si dhe në Statutit të KUB. Konkretisht në aktivitetet e NJSBC janë përfshirë studentët, pedagogët dhe administrata, nëpërmjet anketimeve periodike ata japin mendimin e tyre për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Gjithashtu KUB ka bashkëpunuar me Qendrën Kërkimore „Tirana Business Research Center“ për realizimin e anketës së studentëve dhe pedagogëve për vitin akademik 2020 – 2021.  Evidenca: Dok. 7. Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf Dok. 78.2. Raportet e Pyetëtorit të stafit IQE.pdf Dok. 78.3. Raportet e Pyetëtorit të studentëve IQE.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në bazë të evidencave të shqyrtuara GVJ konstaton se detyrat e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në Rregulloren e NJSBC, Neni 4. Bazuar tek Plani i Punës së NJSBC për Vitin Akademik 2020 – 2021, GVJ konkludon se kjo strukturë ka angazhuar të gjithë anëtarët e stafit në realizimin e detyrave të saj. Raportet e realizuara të NJSBC dhe plani i masave të marra në kuadër të reflektimit për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit tregojnë që detyrat e NJSBC janë kryer me përgjegjësi dhe korektesë nga anëtarët e saj.  Evidenca: Dok. 30. Plani i Punës së NJSBC për Vitin Akademik 2020-2021.pdf Dok. 86. Plani i aktiviteteve për zhvillimin e veprimtarive në përmbushje të rezultateve të pyetëtorit të studentëve dhe personelit akademik në kuadër të përmirësimin të standardeve të cilësisë në KUB.pdf

<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC, GVJ u informua që përgjithësisht anëtarët e saj zgjidhen nga të gjitha njësitë kryesore të KUB, përsa i përket anëtarëve që janë staf akademik. Pra kemi një përfshirje të drejtpërdrejtë të një përfaqësuesi të Fakultetit të Ekonomisë, që është Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Informatikë Biznesi. Aktualisht në përbërjen e NJSBC janë 7 anëtarë nga të cilët 3 janë nga Fakulteti i Ekonomisë, ku 1 prej tyre është pedagog i Departamentit të Ekonomiksit dhe Informatikës.</p> <p>Gjithashtu në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë së programit të studimit janë të përfshirë edhe pedagogët dhe studentët, me anë të mendimeve, sugjerimeve apo nevojave të tyre të cilat jepen me anë të anketimeve por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> <p>Evidencë:</p> <p>Dok. 30.5. Pyetësor i plotësuar i një studenti të programit të studimit Informatikë Biznesi.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimin me përfaqësues të NJSBC, GVJ u informua se kjo njësi ka për qëllim të mbikqyrë mbarëvajtjen e cilësisë së programeve të studimit dhe arritjen e standardeve të larta duke bashkëpunuar me studentët, pedagogët, drejtuesit, etj. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, si dhe takimeve me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Gjatë zhvillimit të pyetësorëve është ruajtur anonimat, dhe integriteti akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përfshirjen e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, KUB e ka përcaktuar në Rregulloren e NJSBC si dhe në Statutin e tij, një anëtar i së cilës është ekspert i jashtëm.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton bashkëpunimin e KUB me kompani të jashtëme, për të realizuar kontrole të pavaruara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë si në aspektin akademik por edhe atë të qëndrueshmërisë financiare. Ndër to mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tirana Business Research Center (TRBC)</li> <li>- Instituti për Cilësi dhe Arsim (IQE)</li> <li>- Grand Thorton</li> </ul> <p>Evidenca:</p> <p><a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464563-593ab8ef-fb46">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464563-593ab8ef-fb46</a></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të shyrtuara si dhe faqes së web-it të KUB, GVJ konstaton se institucioni ka bërë transparente dhe publike për studentët dhe stafin, por edhe publikun e interesuar, të gjithë dokumentat që lidhen me veprimtarinë e NJSBC të tilla si: Rregullorja e NJSBC sipas të cilës është organizuar dhe funksionon kjo njësi; anëtarët e saj; politikat dhe procedurat e ndjekura nga NJSBC për sigurimin e cilësisë; veprimtaritë dhe objektivat e NJSBC; elementët e analizës; elementët e vlerësimit të cilësisë; Raportet Vjetore të NJSBC; Raportet e Vlerësimit të IQE; Planin e Punës së NJSBC; Raportet e Auditimit; Raportet e Vetëvlerësimit, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Të gjitha dokumentat dhe informacionet e publikuara respektojnë, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Evidenca:  <a href="https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464563-593ab8ef-fb46">https://kub.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-njsbc/#1629380464563-593ab8ef-fb46</a>  <a href="https://kub.edu.al/licensimi-dhe-akreditimi/">https://kub.edu.al/licensimi-dhe-akreditimi/</a>  <a href="https://kub.edu.al/akte-ligjore-dhe-dokumenta-te-rendesishme/">https://kub.edu.al/akte-ligjore-dhe-dokumenta-te-rendesishme/</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të shqyrtuara, konstaton se rezultatet e vlerësimit janë marrë në konsideratë dhe janë analizuar nga NJSBC. Në bazë të këtyre rezultateve NJSBC ka hartuar një plan të veprimtarive në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Ky plan përmban veprimtaritë dhe zgjidhjet e propozuara, afatin e kërkuar të realizimit dhe zbatuesit e masave.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron zbatimin e masave të marra dhe analizon impaktin e tyre, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca:  Dok. 86. Plani i aktiviteteve për zhvillimin e veprimtarive në përmbushje të rezultateve të pyetesorit të studentëve dhe personelit akademik në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë tamimit me përfaqësues të NJSBC, se janë organizuar veprimtari periodike për të informuar studentët dhe personelin akademik në lidhje me ndryshimet që janë bërë si rrjedhojë e kërkesave dhe rekomandimeve të tyre, si dhe në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga monitoruesit e jashtëm. Një shembull mund të përmendim prezantimi në institucion i rezultateve të pyetesorëve të IQE për vitin akademik 2020 – 2021 dhe masat e parashikuara për tu marrë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--


## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar “I Biznesit”**

### **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni ofron një infrastrukturë moderne, klasa dhe laboratorë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit, si dhe mjedise të tjera komode, me facilitete për të garantuar një proces mësimor efektiv dhe me standarde të larta.
2. Institucioni ka një përpjekje serioze në bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë si për realizimin e programit të studimit edhe për auditimin e aktivitetit financiar.
3. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrveshesh bashkëpunimi të cilat i mundësojnë realizimin me sukses të programit.
4. Institucioni ka kapacitete optimale financiare për të realizuar me efikasitet programet e studimit që ofron si dhe për të mbështetur kërkimin shkencor dhe kualifikimin e stafit akademik.
5. Institucioni ka pjesëmarrje aktive në programet e mobilitetit të stafit dhe studentëve Erasmus+ si dhe në projekte të përbashkëta Joint Project.

### **Pika të dobta:**


1. Metodologjia mbi të cilën është ndërtuar studimi aktual i tregut, nuk arrin të pasqyrojë problematikat dhe nevojat e bizneseve të vendit, pasi nuk janë reflektuar evidenca nga të dhëna parësore apo dytësore të mbledhura nga ky treg.
2. Literatura bazë e detyrueshme e lëndëve është relativisht e vjetër dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore për përdorimin e literaturës së 5 viteve të fundit. Gjithashtu, vërehet mungesë e teksteve bazë për literaturën e detyrueshme në lëndët e programit të studimit në bibliotekën e institucionit.
3. Mungesa e botimeve shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, të stafit akademik të cilët janë kandidatë për fitimin e gradave shkencore apo titujve akademik.
4. Mungesa e një sistemi të përgjithshëm elektronik të menaxhimit të informacionit që lidh të gjitha njësitë kryesore të institucionit të tilla sekretaria, burimet njerzore, NJSBC, Zyrën e Karrierës dhe Studentit, etj.





## Rekomandime:

1. Të përmirësohet metodologjia e studimit të tregut për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore që përcaktojnë më qartë përputhshmërinë e aftësive dhe kompetencave të fituara nga ky program studimi me tregun aktual të punës në Shqipëri. Gjithashtu të shtrihet ky studim edhe në tregun e jashtëm për ti dhënë studentëve që po diplomohen një orjentim për mundësitë e punësimit drejt këtij tregu.
2. Të rishikohet dhe rinovohet literatura bazë e detyrueshme e lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit. Si dhe të pasurohet biblioteka me tekste bazë për të mbështetur nevojat e lëndëve që mbulohen me cikël leksionesh.
3. Institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin për të botuar artikuj shkencorë në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin e titujve akademikë. Gjithashtu të lidhë marrëveshje me institucione homologe brenda ose jashtë vendit për ti mundësuar stafit kualifikime të mëtejshme apo studime të doktoratës në fushat përkatëse.
4. Institucioni duhet të investojë në implementimin e një sistemi të përgjithshëm elektronik të menaxhimit të informacionit që lidh të gjitha njësitë kryesore të institucionit të tilla sekretaria, burimet njerzore, NJSBC, Zyrën e Karrierës dhe Studentit, etj.
5. Institucioni të shohë mundësinë e angazhimit të një anëtari të personelit akademik efektiv në rolin e Koordinatorit të Programit, në mënyrë që ai të jetë më pranë studentëve dhe pedagogëve dhe në mënyrë më efektive në përmbushjen e kërkesave të këtij pozicioni.
6. Të unifikojnë paraqitjen e lëndëve me emërtimet dhe kodet përkatëse.
7. Institucioni të ofrojë edhe lëndë operationale si Menaxhim Operationesh apo Kërkim Operationesh me qëllim aftësimin e studentëve drejt analizave sasiore të vendimmarrjes dhe përdorimit të burimeve të organizatës si dhe krijimit të produkteve apo shërbimeve të cilat plotësojnë nevojat e konsumatorëve, duke siguruar efikasitetin dhe efektivitetin.




**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “Business Informatics” of the Higher Education Institution “Kolegji Universitar “I Biznesit”.**

**Strengths and affirmations:**

1. The institution offers a modern infrastructure, classrooms and laboratories equipped with information technology tools, as well as other comfortable facilities, that guarantee an effective learning process and with high standards.
2. The institution has a serious effort in cooperation with external experts for internal quality assurance both for the implementation of the study program and for the audit of financial activity.
3. The institution has signed a series of cooperation agreements which enable the successful implementation of the study program.
4. The institution has optimal financial capacities that enable the efficient implementation of the study programs it offers as well as to support the research and qualification of the academic staff.
5. The institution has active participation in Erasmus + staff and student mobility programs as well as in joint projects.


**Weaknesses:**

1. The methodology on which the current market study is built, does not reflect the problems and needs of the country's businesses, because there is no evidence from primary or secondary data collected from this market reflected in the study.
2. Compulsory basic literature is relatively old and not in line with the legal requirements for the use of literature of the last 5 years. Also, there is a lack of basic textbooks for compulsory literature in the subjects of the study program in the library of the institution.
3. Lack of scientific publications in prestigious international journals indexed in Scopus or Web of Science databases, of academic staff who are candidates for obtaining scientific degrees or academic titles.
4. Lack of a general electronic information management system that connects all the main units of the institution such as secretariat, human resources, NJSBC, Office of Career and Student, etc.



### **Recommendations:**

1. To improve the market research methodology for the collection of primary and secondary data that more clearly define the compatibility of the skills and competencies acquired from this study program with the current labor market in Albania. Also, to extend this study to the foreign market to give graduating students an orientation on employment opportunities towards this market.
2. To review and update the compulsory basic literature with literature of the last 5 years. Also, to supply the library with basic texts to support the needs of the subjects covered by the lecture cycle.
3. The institution should initiate incentive mechanisms for staff to publish scientific articles in prestigious international journals indexed in Scopus or Web of Science databases, publications which are a necessity for obtaining academic titles. Also, to cooperate with local and foreign counterpart institutions to enable staff further qualifications or doctoral studies in relevant fields
4. The institution should invest in the implementation of a general electronic information management system that connects all the main units of the institution such as secretariat, human resources, NJSBC, Career and Student Office, etc.
5. The institution should consider the possibility of placing a member of effective academic staff in the role of Program Coordinator, to be closer to students and professors and to effectively perform the requirements of this position.
6. To unify the presentation of courses with the respective names and codes.
7. The institution should also offer operational subjects such as Operations Management or Operations Research in order to train students towards quantitative analysis of decision making and use of organizational resources and the creation of products or services that meet customer needs, ensuring efficiency and effectiveness.



## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X